



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional

“Elektromekanikë”

ofruar nga

Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eli Vyshka

Dr. Ilo Bodi

Tetor/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit me karakter Profesional në “Elektromekanikë”

1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë (KPGJT)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Mekanikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Elektromekanikë”
4	Urdhëri / VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr.395, datë 08.07.2022
5	Urdhëri / VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri / VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Program i Studimit me Karakter Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 5-të në KSHK
17	Stafi akademik PAE / PAK për programin e studimit:	5 PAE / 19 PAK vitin 2023-2024
18	Numri i studentëve për dy vitet e fundit (2022-2024):	2022 – 2023 - 11 studentë 2023 - 2024 - 21 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional në “Elektromekanikë” është hapur me VKM nr. 678, datë 10.11.2021, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 2.9.2015, i licensuar me Urdhër MAS me nr. 451, datë 25.07.2022 dhe ofruar që në vitin 2022 nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë”.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional në “Elektromekanikë” (EM) është Departamenti i Mekanikës (DM).

Njësia Kryesore në të cilën bën pjesë DM është Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë (më tej KPGJT).

Departamenti i Mekanikës është njëri nga 3 (tre) departamentet e Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë (KPGJT).

Regjistrimi i formës së diplomës do të bëhet nga QSHA pas akreditimit të parë të programit të studimit.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në “Elektromekanikë” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Diplomë Profesionale” në “Elektromekanikë”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në dy fundit (2022-2024) është 32 studentë



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që ai kreu në institucion në datat 26-27 shkurt 2024. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, së Sekretarisë, Bibliotekës, etj.

Në bazë të vlerësimit të jashtëm janë: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, disa elementë të Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr. 10247/2010, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave (sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij për standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë për programet e studimit 2-vjeçar me karakter profesional), si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave të sjella nga KPGJT në DVV, dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në vend. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që mbulojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Rajna Lila.

Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 68 /6 Prot, datë 27.09.2024. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, njofton në ASCAL më datë 03.10.2024, me anë të shkresës me Nr.133/4 Prot, datë 03.10.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“ELEKTROMEKANIKË”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë (KPGJT) ka si vizion që të jetë një qendër e risive teknologjike, institucion inovativ në mënyrën e të mësuarit e të ofruarit të programeve profesionale bazuar në tregun e punës, duke u bërë një pikë referimi kombëtare e rajonale në operimin akademik dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit profesional të lartë.</p> <p>GVJ gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, nga informacioni i marrë në DVV, nga takimet e zhvilluara me të gjithë faktorët dhe aktorët, por edhe nga njohjet e tij mendon se misioni i KPGJT dhe programi i studimit Elektromekanikë (EM) është në përputhje me interesat kombëtare.</p> <p>Si theksohet edhe në Strategjinë 2023-2028, “... KPGJT ka si mision të jetë lider për ofrimin e arsimit profesional, duke dhënë kontributin e tij për zhvillimin ekonomik të vendit, duke formuar profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë sonë”.</p> <p><i>Ref: Evidenca 4 Statuti KPGJT, neni 5</i> <i>Ref: Evidenca 5 Strategjia 2023-2028</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>GVJ gjykon se (sipas Statutit të KPGJT dhe DVV) programi i studimit profesional 2 vjeçar në “Elektromekanikë” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KPGJT, si dhe me fushën e veprimtarisë akademike dhe profesionale. KPGJT duke pasur si mision të promovojë punën kërkimore zhvillimore në përputhje me standartet, përparësitë strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit kërkon të kontribuojë në krijimin e një sistemi efikas edukimi, nëpërmjet mësimin mbi bazë pune e përmes teknologjive të përparuara, i aftë të përballojë sfidat e kohës, të cilave ju përgjigjet edhe programi i studimit Elektromekanikë (EM).</p> <p><i>Ref: Evidenca 5 Strategjia 2023-2028 (III. V)</i></p>

	<p><i>Ref: Evidenca 4 Statuti KPGJT, neni 4, 5</i> <i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja KPGJT, neni 1.2</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Nga leximi i dokumentave si: “Statuti”, “Strategjia 2023-2028”, “Rregullore e Programit të studimit”, Organigramën e KPGJT, etj, GVJ mendon se programi i studimit EM është në përputhje me kërkesat e këtyre dokumentave, si dhe ka përputhje me fushat që mbulohen nga Departamenti i Mekanikës (DM).</p> <p>Sipas Statutit të KPGJT-së programi i studimit Elektromekanikë synon të ruajë traditën kombëtare shqiptare të konsoliduar në fushën e elektromekanikës dhe ta vendos atë në funksion të zhvillimeve rajonale.</p> <p>Mendojmë se strategjia për të ofruar programe të tilla 2 vjeçare inxhinierike, i shërben shumë mirë ekonomisë.</p> <p><i>Ref: Evidenca 5 Strategjia 2023-2028</i> <i>Ref: Evidenca 4 Statuti KPGJT, neni 2, 10, 11</i> <i>Ref: Evidenca 6 Rregullore e Departamentit, KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM, neni 3</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Sipas RVB në analizën e tregut, janë përshkruar argumentet që mbështetën hapjen e programit Elektromekanikë të bazuar mbi nevojat e tregut të punës, të mbështetur në të dhëna konkrete dhe në traditën e krijuar në “Grupin Kastrati”.</p> <p>Sipas DVV, GVJ konstaton se për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KPGJT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Konstatojmë se nevoja e tregut të punës për profesionistë në fushën e elektromekanikës është evidentuar nga grupi Kastrati, të cilët sigurojnë edhe qëndrueshmërinë financiare të KPGJT.</p> <p><i>Ref: Evidenca 5 Strategjia 2023-2028</i> <i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e Departamentit, KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 8 Studim tregu për programin e studimit në EM</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga tabela e të dhënave për stafin akademik që realizon kurrikulën e programit të studimit, rezultoi se në vitet akademike 2022-2024 janë përfshirë personel akademik i kualifikuar, i përshtatshëm për lëndët që kanë mbuluar. Që në fillim personeli akademik ka qenë me tituj/grada apo kualifikime sipas kërkesave ligjore. Nga tabela për vitin 2023-2024 rezultoi se nga 5 pedagogë të brendshëm 1 (një) ka titullin Prof. Dr./Akademik, 1 (një) Prof. As. Dr., 1 (një) Dr. dhe 2 të tjerët janë me kualifikimin Msc., si dhe nga 19 pedagogë të jashtëm 3 (tre) kanë titullin Prof. Dr., 2 (dy) Prof. As. Dr., 2 (dy) Dr. 1</p>

CEVY shka

A

	<p>(një) dhe 10 (dhjetë) të tjerët janë me kualifikimin Msc.</p> <p>GVJ evidenton se shumica e pedagogëve janë me profil arsimimi Inxhinier Mekanik dhe Elektrik e Elektronik, me eksperiencë pune të gjatë si në mësimdhënie edhe në industrinë elektromekanike, eksperiencë e nevojshme dhe e mjaftueshme për të mbështetur programin e studimit profesional “Elektromekanikë”.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se KPGJT ka burimet e duhura (auditorë, laboratorë e ofiçinë, bibliotekë, mjete didaktike, etj), të cilat janë në shërbim të programit EM që ofron ky institucion.</p> <p>Sipas RVB e DVV, vizitës në institucion e intervistave me studentët, GVJ konstaton se: ekziston një lidhje e fortë me biznesin dhe industrinë që mundëson kryerjen e praktikave të punës në vend.</p> <p><i>Ref: Tabelat përmbledhëse (Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit)</i> <i>Ref: Evidenca 10 Infrastruktura</i> <i>Ref: Evidenca 11 Laboratorët e KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 12 Infrastruktura IT</i> <i>Ref: Evidenca 9 Dosje e personelit akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane.</p>	<p>GVJ vlerëson që programi i studimit profesional “Elektromekanikë” ofrohet nga Departamenti i Mekanikës, në përputhje të plotë midis fushës së studimeve me strukturën akademike e kërkimore të tij. Në rregulloren e departamentit përcaktohet qartë se fusha akademike dhe kërkimore e departamentit është e orientuar drejt integritit të inxhinierisë mekanike, mekatronike e elektrike.</p> <p>Sipas RVB, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit profesional në “Elektromekanikë” është në përputhje me klasifikimin / kodifikimin e programeve të studimit sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit, me VKM nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022 “Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”. Kodi i këtij programi është 52-PP-0716-S.</p> <p><i>Ref: Tabelat përmbledhëse (stafi në vite)</i> <i>Ref: Evidenca 6 Rregullore e KPGJT, neni 1 Departamenti</i> <i>Ref: Evidenca 15 VKM me nr. 288, datë 11.05.2022</i> <i>Ref: Evidenca 16 VKM me nr. 310, dt. 11.05.2022</i></p>




Konkluzione

- Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë ofron programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, "Elektromekanikë", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë bazë Departamenti i Mekanikës, përgjegjës për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.
- Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.
- Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional EM, mbështetur në VKM me nr. 310, datë 11.05.2022. Kodi i këtij programi studimi është **52-PP-0716-S.**

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në dokumentat e paraqitura nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Elektromekanikë jepen mjaft të dhëna për marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, të cilat janë të sanksionuara qartë edhe në Statutin, rregulloret dhe dokumentat e tjera të KPGJT. Ref: Evidenca 4 Statuti KPGJT, neni 10, 11, 12, 13, 14 Ref: Evidencë 21 Struktura organizative e KPGJT Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM Ref: Evidenca 18 Analiza vjetore 2022-2023 Ref: Evidenca 17 Mbledhje kolektivi në KPGJT
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e	Nga të dhënat që referohen në RVB dhe nga dokumentat në DVV, GVJ konstaton se KPGJT, DM kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, me institucione homologe brenda vendit, si: Universitetin Politeknik të Tiranës UPT, Universitetin "A. Moisiu" të Durrësit UAMD, Universitetin "A. Xhuvani" Elbasan, Universitetin e Prishtinës. Gjithashtu, KPGJT ka evidentuar disa prej Universiteteve të Huaja, me të cilët ka

<p>biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>kontaktuar dhe po punon për të bashkëpunuar në kuadrin e projekteve, financime me programe të tjera, etj.</p> <p>GVJ nga DVV si dhe takimet në vizitë evidenton se KPGJT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi edhe me aktorët e biznesit. Për këtë program studimi janë nënshkruar rreth 11 marrëveshje, që shërbejnë në realizimin me cilësi të programit të studimit. Ky program studimi është inicuar nga grupi Kastrati, pikërisht për formimin e profesionistëve në fushën e automjeteve.</p> <p><i>Ref: Evidenca 19 Marrëveshjet me IAL</i> <i>Ref: Evidence 13, 14 Lista e subjekteve bashkëpunuese</i> <i>Ref: Evidence 40 Marrëveshje me UPT + U. Prishtinë</i> <i>Ref: Evidence 54 Marrëveshje me BiBeKu</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>GVJ nga DVV konstaton se KPGJT në përputhje me objektivat e veprimtarisë zhvilluese synon të ndërtojë ura bashkëpunimi me aktorë vendas të biznesit, që operojnë në fushën e elektromekanikës, ndërtimit, riparimit e shfrytëzimit dhe menaxhimit të automjeteve, etj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve. KPGJT e DM kanë 11 marrëveshje bashkëpunimi me aktorët e biznesit për programin e studimit EM.</p> <p>Udhëheqësi i praktikës mësimore koordinon punën me studentët, drejtuesit e kolegjit dhe drejtuesit e ndërmarrjes. Ky koordinim është i përcaktuar në Rregullore dhe formalizohet nëpërmjet marrëveshjeve zyrtare, në të cilat qartësohen saktësisht detyrat dhe përgjegjësitë e palëve.</p> <p>GVJ mendon se këto marrëveshje janë të përshtatshme për realizimin e objektivave të procesit mësimor, si realizimin e praktikave profesionale, ashtu edhe për punësimin e studentëve.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullore e programit EM, neni 9</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular – mësimdhënies, neni 47 Praktikave profesionale</i> <i>Ref: Evidenca 20 Kontratë për zhvillimin e praktikës profesionale</i> <i>Ref: Evidenca 13, 14 Lista e partnerëve, marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>GVJ konstaton se në DVV është vendosur raporti vjetor i analizës së punës së KPGJT/departamentit dhe në këtë raport është analizuar edhe praktika mësimore dhe bashkëpunimi me</p>

<p>harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>kompani të ndryshme. Po kështu është edhe raporti i praktikave, ku jepen njoftimet dhe mënyra e plotësimit të dokumentacioneve e vlerësimi i studentit për praktikën e kryer.</p> <p>Në RVB citohet se: në analizën vjetore KPGJT, diskuton në mbledhje të hapur me asamblenë e personelit akademik të Departamentit të Mekanikës dhe Departamentet e tjera, merr në analizë edhe bashkëpunimet e Kolegjit në kuadrin e bashkëpunimeve në projekte kombëtare e ndërkombëtare, ku analizohen përfitimet e KPGJT-së nga këto bashkëpunime në kuadrin e realizimit të programit të studimit.</p> <p>Por referuar kriterit majtas dhe dokumentacionit në DVV, <u> nuk ka raport analitik të veçantë, të përfitimeve nga marrëveshjet e nëshkruara. GVJ, sugjeron që këto analiza të realizohen në formën e raporteve të shkruara vjetore, ku të analizohet më me hollësi përfitimet nga këto bashkëpunime.</u></p> <p>Ref: Evidenca 18 Analiza vjetore 2022-2023 Ref: Evidenca 13, 14 Lista e partnerëve, marrëveshjeve të bashkëpunimit Ref: Evidenca 20 Kontratë për zhvillimin e praktikës profesionale Ref: Evidenca 39 Mbledhje Departamenti</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në RVB është deklaruar se KPGJT/DM ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p> <p>Në vitin 2023-2024 diplomohet brezi i parë i studentëve në programin e studimit Elektromekanikë.</p> <p>Sipas nenit 1 të Statutit, KPGJT është krijuar nga shoqëria tregëtare “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë” e cila është pjesë e shoqërive të Grupit Kastrati. Si e tillë, kompanitë brenda këtij grup biznesi janë të interesuar për profesionistët në fushën e elektromekanikës. KPGJT ka rekomanduar studentë, mbështetur në kërkesën e tyre, për punësim pas përfundimit të studimeve pranë këtyre kompanive.</p> <p>https://kpgjt.edu.al/mundesite-e-punesimit-dhe-internship/ https://kpgjt.edu.al/blog/</p> <p>Ref: Evidenca 72 Paketë informuese për studentët Ref: Evidenca 69 Takim me studentët, këshillim karriere</p>
<p>Konkluzione</p> <p>- GVJ konstaton se KPGJT/DM kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione,</p>	





<p>kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë kryesisht sipërmarrjet dhe ofiçinat e shërbimit të automjeteve dhe industrive të tjera elektromekanike, që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale e ku studentët do të punësohen pas diplomimit. - GVJ, sugjeron që këto analiza të realizohen në formën e raporteve të shkruara vjetore, ku të analizohet më me hollësi mbi përfitimet dhe çfarë duhet të përmirësohet në këto bashkëpunime. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e DVV, GVJ konstaton se KPGJT ka struktura të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Strukturat përgjegjëse institucionale deklarohen në organigramë. SBC realizohet nga vetë KPGJT nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese) të KPGJT, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e akteve rregullatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij. • Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). <p>Ref: Evidenca 4 Statuti, neni 49 Ref: Evidenca 59 Organiograma Ref: Evidenca 74 Vendim i Asamblesë së Aksionerëve për ngritjen e strukturave, NjsBC Ref: Evidenca 22 Vendim i Rektoratit për ngritjen e NjsBC</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke</p>	<p>Nga DVV, RVB dhe nga takimi me përfaqësues të NJSBC u konstatua që në KPGJT është ngritur dhe funksionon struktura e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>NJSBC e ka nisur punën që me krijimin e saj, nga 18.11.2022 në</p>

<p>zbatuarnjë strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>formën e një ekipi të përbërë nga 3 anëtarë dhe më pas është plotësuar me 5 pesë anëtarë: dy personel akademik, ku njëri drejtues e një anëtar pedagog, përfaqësues nga Departamentet e KPGJT-së një përfaqësues nga njësitë ndihmëse dhe dy studentë. Drejtuesi i njësisë bazë DM është njëkohësisht dhe Kryetar i NJSBC.</p> <p><i>GVJ evidenton se NJSCB është strukturë relativisht e re, jo plotësisht e konsoliduar në praktikat e punës, por me përpjekje serioze në drejtim të vlerësimit të cilësisë në nivel të njësisë bazë. Ajo është në proces plotësimi, përmirësimi dhe përpilimi të strategjive përkatëse. Krijimi dhe implementimi i këtyre dokumenteve përbëjnë njëkohësisht edhe një prej objektivave strategjik të institucionit.</i></p> <p><i>Nga takimi me titullarët u deklarua se KPGJT do të lidhë marrëveshje për ekspert të jashtëm për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 3 Statuti, neni 50</i> <i>Ref: Evidenca 23 Rregullore e NJSBC, neni 4</i> <i>Ref: Evidence 24 Raport - Formularët e vlerësimit nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga RVB dhe DVV, GVJ konstatoi se KPGJT harton politika dhe ngre struktura përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë.</p> <p>Treguesit për sigurimin e cilësisë në KPGJT janë të përfshira në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kodin e Cilësisë, standardet dhe kriteret përkatëse të të cilit përbëjnë treguesit e matshëm për sigurimin e cilësisë; • Aktet rregullatore (të procesit mësimor, në rregullat e sigurimit të laboratorëve, shëndetin dhe sigurinë e studentëve, etj) <p>Instrumentet për sigurimin e cilësisë në KPGJT janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të institucionit; • Planet e punës mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademik dhe administrative të KPGJT; • Pyetësorët; • Bashkëpunimet për ekspertiza (përfaqësuesit e bizneseve, ekspertët e jashtëm); <p><i>KPGJT aplikoi me 2023 për vlerësimin e jashtëm, akreditimin e parë institucional, sikurse dhe të programeve të studimit që janë në proces.</i></p> <p>GVJ evidenton se Plani e veprimit për 2023-2028, ka në fokus</p>

	<p>rritjen e standardeve të cilësisë, pasi përcakton qartësisht jo vetëm veprimet që do të ndërmeren, por edhe instrumentat që do të përdoren, indikatorët sasiorë dhe cilësorë për monitorimin e tyre, përgjegjësitë dhe kompetencat, afatet kohore, etj, për përmbushjen e tyre.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti, neni 49, 50 Ref: Evidenca 4 Strategjia e zhvillimit 2023-2028, neni IV Ref: Urdhër Rektor nr. 4, datë 01.02.2024 për ngritjen e GVB për akreditimin e programit EM Ref: Vendim Rektorati nr. 4, datë 18.11.2022 për ngritjen e GVB për akreditimin e institucionit Ref: Evidenca 23 Rregullore e NJSBC Ref: Evidencë 53 Informim i Dep. mbi veprimtarinë e NJSBC</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Në rregulloren për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë (të matshëm, që pasqyrojnë arritjet dhe dobësitë). NJSBC vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.</p> <p>Nga RVB dhe DVV shoqëruese, GVJ konstatoi se KPGJT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve.</p> <p>Ref: Evidenca 4 Statuti, neni 49, 50 Ref: Evidenca 24 Raport - Formularet e vlerësimit nga studentët Ref: Evidencë 53 Informim i Dep. mbi veprimtarinë e NJSBC Ref: Evidenca 17 Mbledhje e Asamblesë së Personelit të KPGJT Ref: Evidenca 39 Mbledhje Departamenti DM</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>KPGJT ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme, për sigurimin e cilësisë së Institucionit dhe të programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i> - <i>Institucioni duhet të caktojë një ekspert të jashtëm për NJSCB, si edhe të përzgjidhen drejtues të ndryshëm për NJSCB dhe departamentin, për të patur vlerësim më transparent e të paanshëm.</i> - <i>Institucioni përdor tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</i> 	
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Sipas RVB, dokumentave në DVV rezulton se programi EM është organizuar që të harmonizojë të gjithë komponentet duke përfshirë lëndë me përmbajtje teorike bazë (disiplina të formimit të përgjithshëm, si Bazat e elektronikës, Vizatim teknik dhe ACAD), lëndë të formimit karakterizues të programit, disiplina integruese dhe të zgjedhura dhe veprimtari plotësuese të karakterit formues.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionine DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Elektromekanikë” është i organizuar në lëndë/module dhe aktivitete formuese, leksione, ushtrime, laboratore, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite (ECTS) në total.</p> <p><u>Kategoritë e veprimtarive formuese kanë ndryshime të vogla në raport me VKM 879/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41/2018”, Tabela 1.1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A-Lëndë bazë 14.17%; gjithsej 4 lëndë – sipas VKM 10-15% - është në rregull • Kategoria B-Lëndë karakterizuese 51.67%; gjithsej 13 lëndë – sipas VKM duhet 45-55%, është në rregull • Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese/ grup-lëndë

cekyshko 

	<p>me zgjedhje 12.5%; gjithsej 6 lëndë/module, ku studenti mund të zgjedhë 2 prej tyre – sipas VKM duhet 5-15%, është në rregull</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria D-Lëndë plotësuese 16.67%; gjithsej 1 lëndë + 3 praktika – sipas VKM duhet 10-15%, pra më tepër • Kategoria E-Detyrime përmbyllëse 5%, - Provim diplomimi – sipas VKM duhet 3-5%, është në rregull <p>GVJ rekomandon rregullimin e kategorisë D gjë që do të ndryshonte edhe % e grupeve A-E, duke i sjellë sipas kërkesave të VKM 879/2019.</p> <p>1) Gjuhë angleze (deklarohet A, i detyrueshëm), të vendoset grupi D, duke u ndryshuar me Shkenca kompjuterike dhe informatika (deklarohet D, i detyrueshëm) të vendoset grupi A.</p> <p>2) Procese teknologjike B, i detyrueshëm, me 4 kredite ECTS të bëhet me 5 kredite ECTS, ndërsa Shkenca kompjuterike dhe informatika nga me 5 kredite ECTS të bëhet me 4 kredite ECTS.</p> <p>Me ndryshim të 1 lënde grupi A mbetet me 4 lëndë me 18 kredite ECTS, që bëjnë 15 %, sipas kërkesës së VKM (10-15%)</p> <p>Grupi B nga 62 kredite bëhet 63 kredite që nga llogaritjet dalin 52.50%, pra mbetet sipas kërkesës së VKM (45-55%).</p> <p>Tek grupi D mbesin 1 lëndë + 3 praktikat 18 kredite që i takojnë 15%, pra del në rregull sipas VKM (10-15%).</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM, neni 4</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia, Kreu II</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Tabelat 1-24</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset e EM</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë</p>	<p>Në nenin 3 të Rregullores së programit të studimit përcaktohen “Objektivat e programit të studimit”, të cilat të detajuara shkruhen edhe në RVB, [cit]: <i>përcakton se programi i studimit Elektromekanikë synon të integrojë fushat klasike të inxhinierisë mekanike, inxhinierisë elektrike, inxhinierisë kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit për të realizuar principet bazë të metodologjisë bashkëkohore, të cilët përdoren në të gjitha drejtimet e inxhinierisë së automjeteve.</i></p> <p>Mbi bazën e DVV dhe intervistave me studentët, GVJ konstatoi se aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara</p>

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse dhe nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete si klubet studentore, trajnime, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit EM</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor i programit EM</i> <i>Ref: Evidenca 28 Leksione të hapura – trajnimi i studentëve</i> <i>Ref: Evidenca 70 – Panairi Work study</i> <i>Ref: Evidenca 79 - Vizita të studentëve në biznese</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Sipas RVB dhe Rregullores së programit të studimit, programi me karakter profesional 2-vjeçar “Elektroteknikë” është i organizuar në lëndë/module ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në profilin e fushës së elektromekanikës së automjeteve.</p> <p>Në Nenin 3, pika 2 të Rregullores së programit të studimit 2-vjeçar “Elektromekanikë”, parashikohen (Evidenca 6, citim)</p> <p><i>Njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përfundim të programit synojnë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Zgjidhjen e problemeve profesionale në fushën e elektromekanikës me aplikim drejt sistemeve elektrike dhe elektronike të automobilit;</i> • <i>Formulimin dhe zbatimin e ideve të zhvillimit dhe planifikimit në një sipërmarrje të biznesit të automobilave;</i> • <i>Zbatimin e legjislacionit financiar;</i> • <i>Të kryej kontrollin, matjet në mjetet motorike dhe të realizojë riparimin e sistemeve elektrike dhe elektronike; të përdorë dhe mirëmbaje veglat, pajisjet, aparaturat;</i> • <i>Të njohë dhe zbatojë legjislacionin bazë, standardizimin, rregulloret teknike, sistemet e çertifikimit dhe sigurimit të cilësisë në fushën e elektromekanikës dhe fusha të tjera që lidhen me biznesin kryesor;</i> • <i>Te gjejë dhe përdorë dokumentacionin teknik: manuale, katalogë, etj, si dhe bazën elektronike të të dhënave, etj.</i> <p><i>Sipas planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, studentët në disiplinat karakterizuese marrin njohuri dhe fitojnë kompetenca profesionale në lidhje me materialet që përdoren në elektromekanikë, sistemet mekanike dhe elementët e makinave, sistemet hidraulike dhe termike që përdoren në konstruktimin e mjeteve lëvizëse, proceset teknologjike; pajisjet elektrike dhe sistemet elektronike dhe mekatronike në automjete, instalimet elektrike, matjet në elektromekanikë, elektronika, automatizimi</i></p>

ceVyshe 

	<p>dhe robotika, etj.</p> <p>Objektivat e programit të studimit dhe mundësitë e punësimit publikohen në faqen e internetit të KPGJT, ambientet e institucionit, broshurat informuese, etj.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja KPGJT, neni 7.4</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i> <i>Ref: Evidenca 72 Paketë e KPGJT informuese për studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionine DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Elektromekanikë”, i referohet nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Elektromekanikë” në Kolegjin Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit 2-vjeçar “Elektromekanikë” dhe në planin mësimor janë të përcaktuara ngarkesa në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse:</p> <p>Të gjitha lëndët/modulet janë të shprehura në kredite që janë nga 3-6 kredite. 1 kredit ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Kategoritë e veprimtarive formuese jepen në Kriterin 1, të këtij standardi, ku <i>GVJ ka konstatuar se ka ndryshime të vogla në raport me VKM 879/2019.</i></p> <p>Në program janë parashikuar kredite për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 44 ECTS • Ushtrime/ Seminare 36 ECTS • Laboratorë / Praktika 19 ECTS • Praktikë profesionale 15 ECTS • Provim përfundimtar 6 ECTS <p><i>GVJ mendon se kjo ndarje është pozitive, pasi krahas pjesëve teorike të leksioneve, studenti diskuton në seminare apo zgjidh ushtrime praktike, si edhe kryen vetë veprimtari praktike në laboratorët apo praktikat në teren.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM, neni 4</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrrikular dhe Mësimdhënia, Kreu I, neni 3. 7</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i></p>




<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>KPGJT nuk ka status të veçantë.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ sipas RVB, evidenton se KPGJT ka konsultuar planin mësimor në institucione të arsimit të lartë që ofrojnë program studimi me karakter profesional 2-vjeçar në fushën e “Elektromekanikë”, si Kolegji Profesional i Tiranës (KPT). Nga shqyrtimi i kurrikulave të ofruar nga ky institucion, konstatohet një ngjashmëri mbi 70% me planin mësimor të ofruar nga KPGJT.</p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Plani mësimor EM i Kolegjit Profesional të Tiranës</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ, sipas RVB e planit mësimor konstaton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional EM, mbështetur në VKM 310/2022. Programi i studimit profesional në fushën e “Elektromekanikës” i përket Fushës së Arsimit dhe Trajnimit 0716 sipas KSNA-F 2013. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP--0716-S.</p> <p><i>Për kodifikimin e lëndëve në planin mësimor GVJ konstaton se ka 4 elementë: i pari shpreh inicialet e institucionit KT, i dyti ndjek kronologjinë e semestrave I, II, III, IV; i treti shpreh elementin e veprimtarisë (A-E) dhe i katërti është rankim sipas rëndësisë së lëndës.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 29 Veprimtaritë (A-E) në programin EM</i> <i>Ref: Evidenca 15 VKM 288, 11.05.2022 për miratimin e klasifikimit standard ndërkombëtar</i> <i>Ref: Evidenca 16 VKM 310, 11.05.2022 për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit</i></p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> GVJ konstaton se programi i studimit “Elektromekanikë” organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë 	

ashtu edhe në përmbajtje.

- Janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Bolonjës, ku lëndët modulet janë shprehur në kredite/orë për kredite. Lëndët janë organizuar në disa forma mësimdhënie si: leksione, ushtrime, seminare, laboratore, praktikë profesionale, etj.
- GVJ rekomandon të ndryshohen veprimtaritë (A-E) dhe kreditet për 2 lëndë për përputhjen e saktë të % me VKM 879/2019.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në RVB, Institucioni Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë (KPGJT) përbëhet nga 3 njësi bazë: Departamenti i Mekanikës Departamenti Elektrik Teknologjisë së Informacionit Departamenti i Ndërtimit dhe Infrastrukturës</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit “Elektromekanikë” është Departamenti i Mekanikës, i cili plotëson kriteret ligjore për funksionim. Ajo është Njësi bazë edhe për programin Elektromekanikë, si dhe grupon disiplina mësimore trajnuese të përafërta.</p> <p>GVJ për vlerësimin e këtij kriteri ju referua të dhënave tabelore të deklaruara në DVV, nga të cilat rezulton se: Njësia bazë DM plotëson kriterin ligjor të numrit total se ka në përbërje 5 PAE (numri minimal është 5), dhe plotëson numrin minimal të PAE që kanë tituj/grada sepse ka 1 PAE me titullin Prof. Dr./Akademik, 1 Prof. As. Dr. dhe 1 Dr. (numri minimal është 1)¹. Pjesa tjetër e stafit është asistent-lektor me Msc.</p> <p>KPGJT është institucion i licensuar me Urdhër të Ministër i MAS nr. 451, datë 25.07.2022.</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit, personelit administrativ dhe 2 përfaqësues të studentëve të programit të</p>

¹ VKM nr. 370, datë 26.4.2017 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË” Neni 5.

	<p>studimit.</p> <p>Departamenti i Mekanikës</p> <table border="1" data-bbox="630 353 1200 846"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2022 – 2023</th> <th colspan="2">2023 – 2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>2</td> <td>9</td> <td>2</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>4</td> <td>14</td> <td>5</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ref: Tabelat përmbledhëse (1-24)</i> <i>Ref: Urdhër të Ministër i MAS nr. 451, datë 25.07.2022</i> <i>Ref: Evidenca Urdhër Rektor nr. 4, datë 01.02.2024 "Përngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit "Elektromekanikë"</i></p>	Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	3	1	3	Prof. Asoc.	1	1	1	2	Dr./PhD.	-	2	1	2	Msc.	2	9	2	12	Totali	4	14	5	19
Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	1	3	1	3																															
Prof. Asoc.	1	1	1	2																															
Dr./PhD.	-	2	1	2																															
Msc.	2	9	2	12																															
Totali	4	14	5	19																															
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në RVB, dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit u deklarua se KPGJT dhe njësia bazë DM bashkërendojnë punën e tyre me stafin administrativ si stafin e sekretarisë mësimore për realizimin sa më efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit. Departamenti ka në dispozicion laboratorë, si dhe ofiçina për realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Në Departamentin e Mekanikës është i angazhuar një personel ndihmës akademik (laborant), i cili mbështet seksionet e departamentit në realizimin e praktikave profesionale dhe të orëve përkatëse laboratorike.</p> <p><i>Ref: Tabelat përmbledhëse (1-24), tabela 2</i> <i>Ref: Evidenca 11 Laboratorët</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i></p>																																		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Mekanikës, si njësi bazë për programin e studimit "Elektromekanikë", për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale ka caktuar një pedagog si koordinatör, i cili është përgjegjësi i seksionit të Elektromekanikës. Sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, Koordinatori është përgjegjës për</p>																																		



<p>është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Gjithashtu për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale në mbështetje të Departamentit është dhe stafi administrativ.</p> <p><i>GVJ nga takimet me Drejtuesin e DM dhe të NjBSC konstaton se në rolin e koordinatorit të programit është drejtuesi i departamentit, me shumë eksperiencë menaxhimi, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e programit të studimit EM.</i></p> <p><i>Ref: Takimeve dhe Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies (Kreu I)</i></p>
--	--

Konkluzione

- GVJ konstaton se Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë dhe Njësia bazë, Departamenti i Mekanikës, përgjegjëse për programin e studimit "Elektromekanikë" përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Departamenti ka në përbërje 5 PAE nga të cilët 3 me tituj/grada dhe 19 PAK nga të cilët 7 me tituj/grada.
- GVJ konstaton në rolin e koordinatorit të programit është drejtuesi i departamentit, me shumë eksperiencë menaxhimi, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e programit të studimit EM.
- GVJ konstaton që ka 1 personel ndihmës akademik të dedikuar përgjegjës për laboratorët, për të plotësuar më mirë kërkesat e programeve profesionale, në fushën e automjeteve.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e Programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit të studimit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. DM mban të gjithë dokumentacionin e kurrikulës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e programit të studimit "Elektromekanikë"; • Planin mësimor; • Syllabuset lëndore, të cilat janë hartuar sipas modeleve të kërkuara nga aktet ligjore, përsa i përket elementeve

	<p>përbërës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia. <p>Të gjitha informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, gjenden të depozituara në departament dhe të publikuara në ambientet e KPGJT.</p> <p>Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin edhe në faqen e internetit të KPGJT</p> <p>https://kpgjt.edu.al/programet-e-studimit/</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 32 Orari mësimor</i> <i>Ref: Evidenca 45 Orari i provimeve</i> <i>Ref: Evidenca 46 Vendim DM për ngritje Komision vlerësimi provimi</i> <i>Ref: Evidenca 66 Kalendari akademik</i> <i>Ref: Evidenca 72 Paketë informuese për studentët</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se Plani mësimor i programit të studimit EM është i plotë, me të gjithë informacionin për semestrat, orët mësimore të çdo lënde/moduli, të ndarë sipas formave të mësimdhënies si dhe të ndara në orë mësimore në auditor dhe në orë të punës individuale të studentit.</p> <p><i>GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit studimi i dedikohet aftësisht në praktikë/punë konkrete në profesion" është arritur (sepse 300 orë praktikë direkt në profesion i shtohen orët e laboratoreve (380 orë) krahasuar me 3000 orë gjithsej - rezultojnë rreth 25%).</i></p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullimin e pasaktësive gjë që do të ndryshonte edhe % e grupeve A-E, duke i sjellë saktësisht sipas kërkesave të VKM 879/2019 (Siç u citua edhe në Kriterin 1 të Standartit II.1 më lart). <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Tabelat 1-24</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha</p>	<p>Kriteret e pranimit në KPGJT miratohet me vendim të Senatit Akademik, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin</p>

ceky shles

informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

dhe publikohen rregullisht në portalin U-Albania, faqeve zyrtare faqen e internetit të KPGJT dhe në rrjetin social Facebook të KPGJT-së. Departamenti i Mekanikës, brenda afateve të përcaktuara nga KPGJT mund të propozojë kritere shtesë specifike të pranimit të studentëve në programet e studimit të ofruara prej saj.

Informacionet e plota për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve jepen në nenet 5 e 6 të Rregullores së programit të studimit EM dhe në nenet 18-20 të Kreu-t III të Rregullores së Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia, si edhe në faqen e internetit të KPGJT.

Pranohen për t'u regjistruar pranë KPGJT në programin EM të gjithë ata kandidatë të cilët:

1. Kanë aplikuar në Portalin e Maturës Shtetërore dhe janë shpallur fitues në programin e përzgjedhur të studimit.
2. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit, së bashku me listën e notave (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë).
3. Kryejnë pagimin e tarifës së studimit sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes KPGJT dhe studentit.
4. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e Kontratës së studentit midis tij dhe KPGJT.
5. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj.

Në RVB deklorohet se: *Dokumentat si më lart vihen në dispozicion të studentëve dhe janë të shpalluara në ambientet e shkollës.*

KPGJT dhe Departamenti i Mekanikës u ofrojnë mundësi studentëve për transferimin e studimeve dhe njohjes së krediteve të fituara në një program tjetër studimi. Transferimet në KPGJT lejohen brenda të njëjtit cikël studimi në fusha të njëjta studimi ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. KPGJT lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë.

Sipas RVB, të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës dhe dokumentacionit të studentit duke plotësuar një formular tip. Një Komision *Ad-hoc* i ngritur nga Departamenti i Mekanikës është përgjegjës për njohjen dhe transferimin e

	<p>studimeve.</p> <p><i>GVJ evidenton se deri tani nuk ka patur praktikë për transferimin e studimeve.</i></p> <p>GVJ sipas RVB dhe nga vizita në sekretarinë mësimore, konstaton se, parimet e pranimit të studentëve të rinj, bazohen në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KPGJT në infrastrukturë, burimet njerëzore, analizave të tregut të punës, ecurisë së programeve dhe punësimit të studentëve. Kuotat dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen nga Senati Akademik, para fillimit të vitit akademik, dërgohen pranë organeve përkatëse dhe vendosen në portalin U-Albania si dhe bëhen publike në ambientet e KPGJT.</p> <p><i>GVJ konstaton se, pranimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore të KPGJT.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia, Kreu III, nenet 18-20</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit EM, nene 5-6</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 30 – Vendimet e SA dhe BA për kuotat</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në KPT, GVJ konstaton se, për secilën lëndë të programit të studimit janë hartuar programet lëndore (syllabuset). Ato janë hartuar në përputhje me formatet e miratuara në aktet ligjore. Në çdo syllabus ka detajet e nevojshme për kreditet/orët mësimore për leksionet, ushtrimet, orët e laboratorit, praktikën profesionale, apo detyrimet përmblyëse, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Gjithashtu në syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Syllabuset miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit.</p> <p><i>GVJ sugjeron korigjimin e disa lapsuseve në përcaktimin e kategorisë së lëndës në syllabus (A, B, D) që të përputhen me kategorinë në Tabelën e formave të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 27 Model syllabusi</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i></p>

cekyshke 

	Ref: Tabelat 1-24			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	<p>Në kuadër të përditësimit të kurrikulave, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë, departamenti lidhur me programin e studimit “Elektromekanikë” bën ndryshime në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion apo kurrikulës sipas rregullores së brendshme dhe aktet nënligjore në fuqi .</p> <p>Sipas RVB dhe rregulloreve të KPGJT, Plani mësimor për çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordin e Administrimit, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose profesioneve respektive, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Departamenti bën ndryshime në programin mësimor, sa herë që ka propozime konkrete, të shoqëruara me argumentimin përkatës dhe vetëm para fillimit të vitit akademik.</p> <p><i>GVJ evidenton se deri tani nuk ka patur praktikë për ndryshim të programit të studimit, duke qenë se është në 2 vitet e para të hapjes së këtij programi.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia, Kreu II</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 33 Propozim për hapje programi të ri studimi</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 34 Praktikë e rishikimit dhe miratimit të planit mësimor për vitin akademik 2023-2024</i></p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstaton se Programi i studimit Elektromekanikë është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional. - GVJ sugjeron rishikimin e veprimtarive të lëndëve: “Shkenca kompjuterike dhe informatika” nga veprimtaria D me detyrim të vendoset veprimtaria A po me detyrim dhe nga 5 kredite ECTS të bëhet me 4 ECTS, duke u ndryshuar me lëndën “Gjuha angleze” që nga veprimtaria A me detyrim të vendoset veprimtaria D po me detyrim; si dhe lëndës “Procese teknologjike” e veprimtarisë B me detyrim t’i shtohen kreditet nga 4 ECTS në 5 ECTS. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i lëndëve/apo veprimtarive në përgjithësi është në përputhje me përmbajtjen e temave që përmban lënda. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikës profesionale në fund të semestrit të dytë në vitin e parë dhe në fund të semestrave të parë e të dytë në vitin e dytë, tenton drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Pra ka një shpërndarje të natyrshme të ngarkesës.</p> <p>Ndërthurja e njohurive teorike (leksione) me ato praktike (ushtrime, laboratorë, praktika mësimore, etj) i jep të diplomuarit në këtë program studimi kompetenca profesionale të mjaftueshme për t'u punësuar si teknikë të kualifikuar në industrinë e makinave, në tregun e punës vendas e të huaj.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit EM, nenet 3-4</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të programit të studimit EM dhe formimin profesional të studentëve.</p> <p>Shpërndarja është me 30 kredite për çdo semestër, ku në semestrin e parë janë vendosur lëndët e tipologjisë A dhe D dhe një lëndë B. Ndërsa më tej vazhdojnë lëndët e tipologjisë B dhe C (si lëndë integruese dhe C (si lëndë me zgjedhje), praktika profesionale D dhe në fund diplomimi E.</p> <p>Shpërndarja e krediteve në ngarkesë javore të shprehura në orë mësimore sipas aktiviteteve formuese është proporcionale, duke krijuar një balancim të peshës dhe rëndësisë që zë çdo lëndë në planin mësimor. Ngarkesa semestrale është 750 orë (brenda dhe jashtë auditorit), nga të cilat jo më shumë se 320 orë janë orë në auditor leksione dhe seminare. Ngarkesa javore në auditor e studentit për leksione dhe seminare është mesatarisht 25 orë në javë.</p> <p>Vlerësimi i 1 krediti ECTS është: për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit (përafërsisht 1 orë përgatitje për 1 orë leksion), për seminarët/ushtrimet 14 orë në</p>

	<p>auditor dhe 11 orë punë e pavarur e studentit (përafërsisht 1 orë përgatitje për 1 orë seminare/ushtime).</p> <p>Çdo vit ka dy semestra dhe çdo semestër ka 14 javë mësimore. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës.</p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 32 Orari mësimor</i> <i>Ref: Evidenca 45 Orari i provimeve</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga analiza e planit mësimor dhe tabelës së ndarjes së lëndëve sipas veprimtarive formuese (A-E), GVJ mendon se programi synon arritjen e objektivave nëpërmjet formimit teorik të harmonizuar me atë praktik, nëpërmjet laboratorëve, detyrave të kursit, apo praktikave dhe punëve konkrete.</p> <p>Sipas RVB raporti teori / praktikë është 50% me 50%. Konkretisht nga plani mësimor i programit EM rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orë të formimit teorik (leksion) 528 orë • Orë të formimit teorik + praktik (ushtrime) 504 orë • Orë të formimit praktik (praktikë prof.+laborator) 680 orë • Orë të punimit të diplomës 30 orë • Orë të formimit në auditor gjithsej 1742 orë <p>Megjithatë, nëse orët e ushtrimeve të lëndëve bazë teorike (280 orë) i bashkëngjiten orëve teorike të leksioneve, ndërsa orët e ushtrimeve të lëndëve profesionale² (224 orë) i bashkëngjiten orëve laboratorike dhe orëve të praktikës profesionale (680 orë), rezultati bëhet: 838 / 904 (orë) dhe raporti del 48% orë teorike / 52% orë praktikë, pra GVJ konstaton se raporti teori / praktikë është afërsisht 50%:50%, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2-vjeçar me karakter profesional.</p> <p>GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit studimi i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion" është arritur (sepse 300 orë praktikë direkt në profesion i shtohen orët e praktikës laboratorike të lëndëve të lidhur direkt me profesionin (380 orë) krahasuar me 3000 orë gjithsej -</p>

² Këtu janë futur lëndët: Pajisjet elektrike dhe instalimet në automjet; Bazat e elektronikës; Elementet elektronike dhe lidhjet; Instalimet moderne elektrike; Teknika e pajisjeve të drejtimit; Elementet e makinave; Kontrolli dhe regullimi i proceseve; Mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve; Sistemet logjistike mekatronike.




	<p><i>rezultojnë 23%).</i></p> <p>Nga RVB evidentojmë se programi i studimit Elektromekanikë është hartuar duke mbajtur në konsideratë programe të ngjashme të kolegjeve profesionale brenda vendit dhe të universiteteve të huaja me të cilat KPGJT ka bashkëpunuar.</p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se në programin e studimit me karakter profesional në “Elektromekanikë” ndarja sipas veprimtarive formuese, (A-E) krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, në përputhje me objektivat formuese të tij. Ndërtimi i programit sipas parimeve të Bolonjës, u mundëson studentëve transferimin e studimeve nga dhe në institucione të tjera.</p> <p>KPGJT ka ngritur disa laboratorë ku studentët krahas njohurive teorike, realizojnë orët praktike, formohen individualisht dhe në grup për aftësitë dhe shkathtësitë që nevojiten në profesion. Për praktikat profesionale shërbejnë edhe ofiçinat e Kastrati Grup.</p> <p>Përafrimi i programit me programe të ngjashme të kolegjeve të tjerë profesionale mundëson jo vetëm transferimin e studimeve, mobilitete të studentëve pranë kolegjeve në vende të huaja, por edhe punësimin në një treg pune jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar.</p> <p><i>GVJ eidenton se ky është brezi i parë i studentëve që do të diplomohen në programin Elektromekanikë.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 70 Panairi i punës Work and Study</i> <i>Ref: Evidenca 71 Kërkesë studenti për praktikë</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Mbi bazën e RVB dhe DVV, GVJ konstaton se programet e lëndëve janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit, (u deklarua se synohet literatura bashkëkohore e 5 viteve të fundit).</p> <p>Syllabuset rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, dhe miratohen nga Drejtuesi i departamentit. Bashkëpunimi dhe mundësia e aksesit në biblioteka online, mundëson përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. GVJ u interesua në bibliotekë nëse literatura e rekomanduar është pjesë e bibliotekës dhe rezultoi që në të gjitha rastet ato janë në departamet, ose në bibliotekë.</p>

ce Vyshtes *A*

	<p>Pedagogët japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës dhe bëjnë propozime për përditësimin/përmirësimin e programit lëndor, përfshirë këtu edhe literaturën bazë dhe atë ndihmëse, në funksion të arritjes së objektivave formuese të programit.</p> <p>GVJ konstaton se analiza e performancës së programit të studimit është pjesë e analizës vjetore të Departamentit, kjo sjell reflektim edhe në punën për përmirësimin e syllabuseve.</p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 60 Fondi i librave në bibliotekë</i> <i>Ref: Evidence 62 Pagesa për mobilitete</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>GVJ konstaton se bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, është saksionuar në Rregulloren e programit të studimit Elektromekanikë. Mentorimi i praktikës bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit, e sipas dokumentacioneve shoqëruese për të.</p> <p>Nga DVV GVJ evidenton se është paraqitur tabela me marrëveshjet me punëdhënësit, ku studentët bëjnë praktikën.</p> <p>Sipas RVB, në KPGJT <i>Praktikat profesionale janë kryer kryesisht në qendrat e kontrollit dhe shërbimeve të automjeteve, që janë pjesë e Grupit Kastrati si dhe në kompani të tjera që operojnë në fushën e mekanikës dhe të teknologjisë së automobil. Praktika kryhet nën tutoriazhin e personelit akademik të departamentit të mekanikës, si dhe nën kujdesin e një punonjësi të subjektit ku kryhet praktika.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullore departamenti, neni 2.8</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullore e programit EM, neni 9</i> <i>Ref: Evidenca 14 Marrëveshje bashkëpunimi me bizneset</i> <i>Ref: Evidenca 5.2 Raporti i praktikave</i> <i>Ref: Evidenca 37 Dosje e praktikës profesionale</i> <i>Ref: Evidenca 20 Kontratë për zhvillimin e praktikës</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi, që synon formimin e teknikëve të lartë në fushën e elektromekanikës së automjeteve.</p> <p>Kompetencat e synuara të të diplomuarve janë: njohuri dhe përgatitje e elektromekanikëve të mjeteve automobilistike, të cilët njohin pajisjet elektrike dhe elektronike të automjeteve dhe skemat e tyre, mund të bëjnë vlerësimin e tyre nga ana funksionale, bëjnë diagnostikimin dhe riparimet e defekteve</p>

	<p>elektromekanike, si dhe japin sigurinë e tyre në punë. Këto kompetenca janë konform me përshkruesit e nivelit 5 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar me ligjin nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.</p> <p>Nga takimet me studentët GVJ konstatoi se një pjesë e tyre janë të punësuar “part time” në orare të cilat nuk pengojnë në vazhdimin dhe realizimin e procesit mësimor për ta. Gjithashtu si pjesë e praktikave organizohen vizita në terren të studentëve në shoqërimin dhe mbikqyrjen e pedagogëve të ndryshëm në biznese, industri, për të parë nga afër, njohur dhe familiarizuar me procese pune, procedura, etj, si dhe me vetë ambientin dhe kulturën e punës.</p> <p>Sipas RVB, KPGJT mbështet përmirësimin e programit të studimit Elektromekanikë si në vlerësimin/mendimin e avancuar pedagogjik ashtu edhe në mendimin e studentëve.</p> <p><i>Ref: Evidence 79 Vizita të studentëve në biznese</i></p>
--	--

Konkluzione

- GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese të synuara dhe me nivelin 5 të KSHK.
- Rezultatet e të nxënit, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- GVJ konstaton se raporti teori / praktikë është afërsisht 50% : 50%, në përputhje me profilin e programit të studimit, duke plotësuar kërkesën e kriterit si një program jouniversitar 2-vjeçar me karakter profesional.
- GVJ mendon se kriteri që “Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion” është arritur.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

(Signature)

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se KPGJT, për përgatitjen dhe hartimin e programit të studimit në Elektromekanikë diskutimet, që u zhvilluan paralelisht me organizimin e hapjes së dy programeve të tjera të studimit në Departamentin e Mekanikës, u kryen me një partneritet të gjerë, përfshirë Drejtorinë e Transportit Rrugor, përfaqësinë Mercedes-Benz dhe disa përfaqësi të fushës që mbulojnë këto dy programe, për përafrimin e tyre me teknologjitë e reja, në sektorin elektromekanik dhe të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse si dhe sektorë të tjerë të lidhur me të.</p> <p>Për këtë program studimi ka disa marrëveshje me aktorë të tregut të punës, ku krahas kryerjes së praktikave profesionale, ato shërbejnë edhe për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>Nga takimet me titullarët e institucionit del se KPGJT organizon konsultime me partnerët me synim azhornimin me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 5 Strategjia 2023-2028, Kreu IV</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ në takimet me studentët dhe drejtuesit e departamentit u informua se KPGJT/DM ka përfshirë studentët në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit në formën që çdo personel akademik, në fund të semestrit mbledh mendime/ sugjerime nga studentët. Këto i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit. Përfshirja e studentëve, si anëtarë të GVB është bërë me urdhër të Rektorit, si pjesë e këtij angazhimi.</p> <p>Në bazë të DVV, GVJ konstatoi se KPGJT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, ku në qendër janë shqetësimi për kënaqësinë e tyre për programin, mjetet laboratorike etj. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p>Bazuar në RVB dhe konstatimet nga takimet e zhvilluara në KPGJT, rezulton se në kuadër të bashkëpunimeve, organizojnë takime me stafin, studentët, kërkues dhe partnerë në sektorë për të evidentuar marrëdhënien IAL-biznes, përfshirë punësimin. Duke qënë se kolegji është në vitin e dytë të funksionimit, reflektimi i mendimeve dhe propozimeve në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit u morrën parasysh me plotësimin e bazës laboratorike dhe krijimin e kushteve optimale të zhvillimit të praktikave mësimore brenda ambienteve të kolegjit dhe më gjerë.</p> <p><i>Ref: Evidencë 38 Kërkesë për plotësim të bazës laboratorike dhe materialeve didaktike</i></p>




<i>Ref: Evidenca 24 Formularët e vlerësimit Studentë</i>				
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.	<p>Në fund të vitit bëhet analiza e performancës së programit të studimit si pjesë e analizës vjetore të Departamentit. Pedagogët e DM si njësia përgjegjëse për programin e studimit “Elektromekanikë” japin mendimet e tyre në lidhje me zhvillimin e lëndës, arrijtet e objektivave, problematikat e hasura dhe mendime e sugjerime për përmirësime të programit lëndor, literaturës, nevojës për bazë laboratorike apo materiale të tjera didaktike, etj.</p> <p>Sipas RVB dhe takimeve në institucion me titullarët, GVJ konstaton se KPGJT, me anë të bashkëpunimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, kontakteve intensive me subjekte ekonomike të bizneseve në fushën e inxhinierisë së mjeteve lëvizëse, aktivizimi si pedagogë të ftuar i ekspertëve dhe profesionistëve të kësaj fushe, kanë krijuar mundësi që të përmirësohet baza laboratorike e KPGJT, të diskutohen mundësitë për përmirësim dhe përditësim të përmbajtjes së programit të studimit, për të qenë i azhornuar me dinamikën e trendeve ekonomike, sociale dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Eksperiencat dhe bashkëpunimet kombëtare e ndërkombëtare si dhe mobilitetet e stafit akademik të Departamentit të Mekanikës, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve në përputhje me zhvillimet e fundit.</p>			
	<p><i>Ref: Evidenca 18 Analiza vjetore Institucionale</i> <i>Ref: Evidenca 39 Raportimi i Pedagogut</i> <i>Ref: Evidenca 14 Marrëveshje bashkëpunimi me bizneset</i> <i>Ref: Evidencë 40 Marrëveshje bashkëpunimi me UP, Kosovë</i> <i>Ref: Evidenca 19 Marrëveshje bashkëpunimi me IAL</i> <i>Ref: Evidenca 49 Marrëveshje bashkëpunimi me BiBeKu GmbH</i></p>			
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> - KPGJT dhe DM në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit nxisin përfshirjen e studentëve, si dhe partnerëve. - GVJ konstaton se programi është përmirësuar edhe me ndryshimet e ardhura si rezultat i propozimeve të pedagogëve dhe bashkëpunitorëve. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------




standardeve të fushës II	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ, bazuar në planin mësimor të programit të studimit “Elektromekanikë”, për vitin 2022-2023, konstaton se në program janë parashikuar orë mësimore në auditor /jashtë auditorit, për elementët e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 528 orë mësimore • Ushtrime 504 orë mësimore • Laboratorë/Praktikë 380 orë mësimore • Praktikë profesionale 300 orë mësimore • Provim diplomimi 30 orë mësimore • Orë jashtë auditorit 1258 orë (orë studimi individual) <p>Praktika profesionale zhvillohet pranë Kastrati Grup dhe organizatave, kompanive dhe bizneseve me të cilat KPGJT ka akt marrëveshje për bashkëpunim.</p> <p>Në Rregulloren e EM, Kreu IV është vendosur që në përfundim studentët të mbrojnë diplomën me temë (punim diplome).</p> <p>Mendojmë se format e ndryshme të mësimdhënies e rrisin cilësinë e këtij programi studimi. Sipas RVB dhe rregullores së programit EM, frekuentimi i orëve mësimore leksione, seminare, ushtrime është i detyrueshëm në masën 75%, ndërsa për laboratore, punë praktike e praktika mësimore në masën 100%.</p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit EM</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik në përgjithësi i përgjigjen cilësisht nevojave të studentëve. Në syllabuse janë parashikuar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. GVJ në takimin me personelin akademik</p>

<p>studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>konstatoi se për plotësimin e nevojave shtesë të studentëve bëhen edhe konsultime.</p> <p>Në procesin e mësimdhënies përdoren edhe mjetet audio vizive për seminare të veçanta apo seanca praktike shtesë.</p> <p>Në përgjigje të pyetësorit me mendimet e studentëve janë identifikuar nevojat e ndryshme të studentëve në lidhje me lëndët mësimore (video, leksione, ushtrime të zgjidhura, ushtrime të pazgjidhura, seanca praktike, etj)</p> <p>Këto diskutohen në grupet mësimore e departament, për plotësimin e tyre me konsultime shtesë, gjetjes së mundësive alternative të mësimdhënies për t'ju përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve, etj.</p> <p>Stafi akademik synon në drejtim të asimilimit të informacionit teorik edhe përmes zbatimit të saj në praktikë.</p> <p>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM Ref: Evidenca 24 Mendimet e studentëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, KPGJT ka vepruar si në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë, laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, etj; ashtu edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së pedagogëve në leksione të hapura, të organizuara me profesorë vendas e të huaj, organizimi i veprimtarive trajnuese të stafit, apo pjesëmarrja e personelit akademik pa eksperiencë mësimdhënëse në leksionet e një pedagogu me eksperiencë, qoftë ky efektiv apo i ftuar.</p> <p><i>GVJ konstaton se KPGJT është në vitin e dytë të aktivitetit akademik, ndaj akoma nuk ka realizuar projekte bashkëpunimi me partnerë vendas e të huaj, nëpërmjet të cilëve të bëj të mundur të zgjerojë mundësitë për kualifikime e trajnim të mëtejshëm të personelit akademik.</i></p> <p>Ref: Evidenca 42 Leksione të hapura me pedagogë vendas e të huaj Ref: Evidenca 43 Veprimtari të stafit në kuadër të trajnimeve</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Nga RVB deklarohet se DM ka përzgjedhur personelin akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme me kompetencë të mjaftueshme për disiplinat ku angazhohet në mësimdhënie. I gjithë stafi zhvillon veprimtarinë e tij akademike</p>

<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p><i>brenda fushës së kompetencës që ka, referuar fushës së studimeve që ka përfunduar, fushës së kualifikimit, eksperiencës totale në punë dhe eksperiencës në mësimdhënie.</i></p> <p>GVJ, mbështetur në DVV për punën shkencore të personelit akademik, në takimet me anëtarë të tij, si dhe në takimet me studentë konstatoi përgjegjshmëri dhe një staf që punon i angazhuar për dhënien e njohurive si dhe për zhvillimin e lëndëve me cilësi.</p> <p>Personeli akademik i kushton rëndësi formave interaktive për të angazhuar sa më shumë studentët në diskutime, demonstrimet nëpërmjet videove, simulimeve të situatave të ndryshme nëpërmjet platformës ELECTUDE https://kpgjt.edu.al/electude/. Kjo metodë mbështetet në parimin e “të mësuarit duke bërë”.</p> <p>KPGJT nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie.</p> <p><i>Ref: Evidenca 36 Plani për kualifikimin e personelit akademik</i> <i>Ref: Evidenca 44 Manual i pajisjes laboratorike</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Në Rregulloren e programit EM (nenet 8, 11, 12) citohet se <i>Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga Departamenti dhe miratohet sipas përcaktimeve në Statutin e KPGJT. Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimdhënës, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime.</i></p> <p>Departamenti i Mekanikës, si njësia bazë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve.</p> <p>GVJ mendon se ky proces është pozitiv dhe të dy palët rritin përgjegjshmërinë, si pedagogët, por edhe studentët.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullore e programit EM</i> <i>Ref: Evidenca 24 Mendimet e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB e DVV, eidenton se është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), si njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të KPGJT.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë garanton cilësinë e veprimtarisë së institucionit, që ajo të kryhet në përputhje me dispozitat</p>




<p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>ligjore dhe në të njëjtën kohë në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat e KPGJT.</p> <p>Në rregulloren e NJBSC jepet misioni për SBC:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i sistemit funksional të vlerësimit të cilësisë në përputhje me standartet kombëtare e ndërkombëtare; - Zhvillimi i një SC të programuar, i cili siguron përmirësimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes akademike e administrative; - Nxitja e marrjes së masave për funksionimin institucional që synojnë përmirësimin e cilësisë. <p>GVJ konstaton se NJBSC vlerëson efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese të KPGJT si dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme. Për ushtrimin e funksioneve të saj, NjBSC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia përbëhet nga Kryetari, nga anëtarë që përfaqësojnë departamentin, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.</p> <p><i>Ref: Evidenca 23 Rregullore NjBSC</i> <i>Ref: Evidenca 24 Mendimet e studentëve</i></p>
---	--

Konkluzione

GVJ konstaton se KPGJT dhe DM punojnë për të garantuar:

- cilësi në procesin e të nxënit, nëpërmjet organizimit të mësimdhënies me forma të larmishme të mësimdhënies si: leksione, ushtrime, laboratorë, detyra, praktikë profesionale, etj. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%, ndërsa i laboratorëve e praktikave në masën 100%.
- aftësimin profesional të personelit akademik që zbaton metodat mësimdhënëse me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve pozitive.
- monitorimin e proceseve të mësimdhënies dhe promovimin nga strukturat përgjegjëse që ngrihen nga DM në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të Rezultatet janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve edhe nga studentët.


Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e KPGJT, në të cilën përcaktohen rregullat e provimeve, rregullat për ankimimin e notave, etj; • Rregulloren e programit të studimit “Elektromekanikë”; • Syllabuset e lëndëve, ku në një rubrikë të caktuar ka të detyrueshme edhe mënyrën e vlerësimit të njohurive; • Rregulloren e e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies (që sqarojnë rregullat për regjistrimet në provime, riprovime etj); <p>Të gjitha rregullat bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>KPGJT mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja KPGJT, neni 5.4 (pikat 4-7)</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM, neni 8</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, Kreu V, nenet 28-36</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga intervista me studentët, [takim me studentët, takim me stafin akademik] nga RVB si dhe dosja VV, konstatohet se studentët marrin informacione të plota për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset nga titullari i lëndës/modulit. Informimi bëhet në fillim të vitit të parë dhe në fillim të çdo lënde/moduli.</p> <p>GVJ konstatoi se ky informacion gjendet si fizikisht në ambientet e shkollës, ashtu edhe përmes informimit nga sekretaria. Informacioni sqarohet edhe gjatë Javës orientuese të fillimit të vitit akademik si dhe nga çdo pedagog për lëndën e tij përkatësisht.</p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 73 Java e Orientimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe</p>	<p>Nga rregullorja e programit të studimit, rregullorja e KPGJT, rezulton se vlerësimi për lëndët mësimore bëhet përmes sistemit të notave nga 5 (note kaluese) deri në 10, ndërsa vlerësimi i provimeve bëhet me sistemin e vlerësimit me 100 pikë, ku vlera përkatëse konvertohet në notë. Nota kaluese më e ulët që është 5 i korrespondon 45% të pikëve të fituara nga studenti.</p>





<p>kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit bëhet gjatë gjithë semestrit dhe është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar 60 % • Provimi i ndërmjetëm 10% • Kolokiume/Detyra kursi/Laboratorë 20% • Aktivizimi në seminare/ushtrime 10%. <p>Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studentit përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës, sipas dokumentacionit të përcaktuar në Kontratën për zhvillimin praktikave profesionale, që mbrohet para një komisioni <i>ad hoc</i>.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i> <i>Ref: Evidenca 45 Orari i provimeve</i> <i>Ref: Evidenca 20 Kontratë për zhvillimin e praktikës</i></p>
---	--

Konkluzione

- GVJ konkludon se KPGJT dhe DM kanë hartuar a) rregulloren e brendshme të departamentit, KPGJT, b) rregulloren e programit të studimit Elektromekanikë, c) rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, d) kontratë për zhvillimin e praktikës profesionale si dhe e) syllabuset, ku përcaktohen procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.
- Gjatë vizitës GVJ konstatoi se KPGJT garanton zbatimin e tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.


Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari</p>	<p>Siç është shkruar edhe më lart, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Kriteri që përcakton që provimi përfundimtar ka një peshë 60% të vlerësimit të përgjithshëm, ndërsa vlerësimi i vazhdueshëm zë një peshë rreth 40% është i përgjithshëm, por sipas specifikave nga titullari i lëndës mund të saktësohet/përcaktohet pesha e</p>




<p>i lëndës/modulit.</p>	<p>elementëve të vlerësimit të vazhduar e cila reflektohet në syllabus, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 13 Programi mësimor i lëndës citohet: <i>Ndryshimet në syllabus propozohen nga titullari i lëndës, vlerësohen nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS-ja) dhe miratohet para fillimit të vitit të ri akademik nga Drejtuesi i Departamentit dhe Rektori.</i></p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve, me shkrim dhe/ose me gojë, vlerësohet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë).</p> <p><i>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive bëhet nga komisioni, që ngrihen nga Drejtuesi i Departamentit të Mekanikës dhe miratohet nga Rektori, këto komisione bëhen publike përpara datës së përcaktuar për kontrollin e dijes.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM, neni 8</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, Kreu V, VII Praktika, VIII Diplomimi</i> <i>Ref: Evidenca 46 Vendim për ngritje Komisioni vlerësimi dije</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në KPGJT, aktualisht nuk përdoret sistem elektronik testimi dhe vlerësimi për studentët, por në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 32 Provimi / kontrolli i dijeve citohet: <i>Provimet me shkrim bëhen të sekretuara dhe zgjasin 2-4 orë.....</i></p> <p>Në RVB theksohet që: <i>procesi i vlerësimit është transparent, pasi studentët njihen me rezultatet e tyre, të cilat krahasohen me çelësin e zgjidhjeve dhe kanë të drejtën të sqarohen ose të ankimohen nëse nuk janë dakord,</i></p> <p>Bazuar në Rregullore: <i>Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës (fleta e provimit).</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga personeli akademik i lëndës dhe asistenti (ose pedagog tjetër i afërt me atë disiplinë, i caktuar nga Përgj. i Dep.) në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në seksretarinë mësimore GVJ konstatoi këtë në</p>




	<p>procesverbalet e paraqitura.</p> <p><i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimit dhe mësimit</i> <i>Ref: Evidence 46 Vendimi i ngritjes së komisionit të provimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me takime me studentët ku jepen komente dhe këshilla mbi procesin e të nxënimit, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Në RVB theksohet që: një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre (edhe komentin me shkrim nga ana e pedagogut në tezen e provimit sa herë ai e shikon të nevojshme dhe të arsyeshme për t'i bërë); - të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me saktësinë e korrigjimit dhe vlerësimin nga ana e pedagogut. <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstatoi që njësitë përgjegjëse kanë treguar seriozitet për plagjiaturën, kopjimin etj.</p> <p>Studentët të cilët ndjekin studimet në programin EM, kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë kolegji, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (mos kopjimi, mos mashtrimi gjatë procesit mësimor, plagjiaturat e çdo forme, etj. të përcaktuara me detaje në këtë kod). Këto dispozita janë të reflektuara në të gjitha Syllabuset e lëndëve, të cilat i vihen studentit në dispozicion në fillim të semestrit.</p> <p>Sipas RVB dhe Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimit dhe mësimit, neni 32 [cit]: <i>Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celular apo mjeteve të dyshimta elektronike. Studenti që në provim përdor formë të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni Drejtuesin e njësisë bazë, për të proceduar më tej në përputhje me kodin e etikës së KPGJT.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i></p>

	<p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset e programit EM</i> <i>Ref: Evidenca 47 Kodi i Etikës në KPGJT</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Siç citohet në RVB e Rregulloren e programit të studimit EM: Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në Sekretarinë Mësimore jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij. Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore në procesverbalin përfundimtar të lëndës bën shënimin “Nuk u paraqit”. Vlerësimi për komponentët e tjerë të vlerësimit duhet të dorëzohet përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p>Në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 32 Provimi / kontrolli i dijeve citohet: <i>Në të gjitha format e organizimit të provimit studenti merr vlerësimin përkatës jo më vonë se 5 ditë pune nga data e dhënies së provimit.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit, pika 5.4.10</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit EM</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KPGJT dhe DM, garantojnë të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit parashikohet e drejta e ankimit / apelit të studentit. Pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Më pas, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim apo kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Drejtuesi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni Rektorin.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i></p>




<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në vazhdim të kriterit më lart, GVJ konstatoi se për çdo kërkesë/ankimim ndiqet kjo procedurë: Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin të ri të firmosur nga komisioni, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe pasqyrohet në regjistrat e arritjes akademike të studentit në Sekretarinate Mësimore.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregullorja e brendshme e departamentit</i> <i>Ref: Evidenca 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 33</i></p>
--	--

Konkluzione

KPGJT / DM dhe pedagogët synojnë të sigurojnë që:

- Vlerësimi i studentëve të jetë i drejtë dhe transparent për provimet apo çdo formë mësimdhënie.
- Vlerësimi të bazohet në meritën e çdo studenti, duke luftuar vjedhjen, plagjaturën, kopjimin.
- Çdo student të ketë të drejtë edhe procesin e ankimimit, sipas një procedure të përcaktuar dhe të njohur më herët prej tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në takimin me studentët GVJ kostaton se kurrikula e programit të studimit “Elektromekanikë” garanton marrjen e njohurive në lëndë bazë (Vizatim teknik dhe ACAD, Bazat e makinerisë, Bazat e elektronikës), si dhe zhvillimin e aftësive të veçanta për specialistë të fushës së elektromekanikës së automjeteve në mirëmbajtje, shërbime, riparime, diagnostikime të pajisjeve elektrike e elektronike dhe sistemeve të tyre, etj. Ndarja në orë</p>

	<p>teorike dhe praktike forcon marrjen e shprehive dhe kompetencave në proceset e mësipërme.</p> <p><i>GVJ mendon se thellimi i njohurive realizohet edhe nëpërmjet laboratorëve dhe punës në orët e praktikës profesionale.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset TA</i> <i>Ref: Evidenca 72 Paketë informuese për studentët e KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 26 Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Në kuadër të formimit të profesionistit që duhet të ketë aftësi edhe në fusha si teknologjia, në fushat sociale dhe të komunikimit, GVJ analizoi lëndët dhe syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se kurrikula e programit të studimit dhe veçanërisht lëndët: Shkenca kompjuterike dhe informatike, Automatizim dhe robotikë, Komunikimi dhe menaxhimi i biznesit, Gjuha angleze e Shkrim akademik synojnë të garantojnë njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 29.1 Plan programi i EM</i> <i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p><i>Nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se studentët e KPGJT, që përfunduan vitin e parë të studimeve, shprehën opinionin e tyre mbi programin e studimit, aftësitë e përftuara në përfundim të programit të studimit si dhe paraqitën rekomandimet e tyre për përmirësim.</i></p> <p>Pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të materialit të trajtuar, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.</p> <p>Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi, si edhe për peshën që do të ketë ai në notën përfundimtare dhe orienton studentët për detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuset EM</i> <i>Ref: Evidenca 39 Raportimi i pedagogut</i> <i>Ref: Evidenca 18 Analiza vjetore 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë</p>	<p>Mësimdhënia për programin e studimit “Elektromekanikë” realizohet në kombinim të orëve teorike si dhe orëve praktike,</p>

<p>kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>në laboratorët dhe ofiçinën në ambientet e KPGJT. Organizimi i punëve laboratorike bëhet në grupe të vogla, ku studentët testohen t'i aplikojnë kompetencat e fituara nëpërmjet simulimit të situatave të ndryshme nga pedagogu dhe diskutimi me studentët për shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar.</p> <p>Realizimi i praktikave profesionale është një pikë e fortë e këtij institucioni dhe garantohet më së pari nga Kastrati group, si dhe nga marrëveshjet bashkëpunuese që KPGJT ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit siç janë: "Auto-Star Albania", "Porsche Albania sh.p.k.", Auto Master, Everest sh.p.k., Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor, etj, ku studentët materializojnë dijet e fituara. Mbrojtja e relacioneve të punimeve të kryera gjatë praktikave profesionale ka për qëllim testimin e kompetencave të fituara e të zhvilluara gjatë studimeve.</p> <p>Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë synon për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. KPGJT bashkëpunon me disa IAL në fushat akademike me interes të përbashkët (shkëmbim stafi akademik, personel administrativ, shkëmbim studentësh, shkëmbim të materialeve akademike, etj). Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se studentët falë simulimit Electude tërhiqen menjëherë nga mjedisi unik i të mësuarit për gamifikimin 3D. Kjo metodë e bazuar në zbulime ka të bëjë me "të mësuarit duke bërë".</p> <p><i>Ref: Evidenca 11+12 Laboratorët + laboratorët IT</i> <i>Ref: Evidenca 13 Lista e partnerëve dhe subjekteve</i> <i>Ref: Evidenca 19 Marrëveshje bashkëpunimi me IAL</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB deklarohet se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë zhvillon leksione, orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të teknologjisë dhe shkencës dhe për t'ju shërbyer studentëve me shembuj të praktikave të suksesshme.</p> <p>Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e portofolit të KPGJT. KPGJT prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë, duke organizuar takime të ndryshme në mjedise teknologjike siç mund të jenë: vizita në kompani, sektorë industrialë apo biznese lokalë.</p> <p><i>Ref: Evidenca 42 Leksione të hapura me pedagogë vendas e të huaj</i> https://www.youtube.com/watch?v=TqD48NCvTxw</p>

https://kpgjt.edu.al/wp-content/uploads/2023/08/Veprimtaria-Pergjegjësia-Sociale-KPGJT-small.pdf Ref: Evidenca 79 Vizita të studentëve në biznese				
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> - GVJ vlerëson se programi i studimit profesional “Elektromekanikë” synon të rrisë aftësitë krijuese dhe zbatuese tek studentët dhe veprimtaritë mësimore jashtë auditorit synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ata. - Realizimi i praktikave profesionale garantohej nga laboratorët e ofiçinat e KPGJT, nga Kastrati group si edhe marrëveshjet bashkëpunuese që KPGJT, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit. - Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e portofolit të KPGJT. KPGJT prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>GVJ eidenton se në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mësimdhënies dhe të programit të studimit të cilat janë publike, specifikohen qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Nga takimi me drejtuesit u deklarua se me detyrimet përmbyllëse studentët e vitit të fundit (dytë) njihen paraprakisht në fund të semestrit të parë, ku informohen për procedurën e diplomimit. Detyrimet për çdo lëndë jepen në çdo syllabus, në mënyrë që studenti të përgatisë materialet që duhet të dorëzojë, si punime të punëve të laboratorëve, detyra kursi, mbrojtja e praktikës profesionale.</p> <p>Sipas Rregulloreve të KPGJT detyrimi përmbyllës është provimi i përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtja e një punimi Diplome.</p> <p>Ref: Evidenca 6 Rregullorja KPGJT, pika 2.9 Ref: Evidenca 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, Kreu VIII, nenet 45-53</p>
Kriteri 2. Strukturat	Nga takimi me stafin dhe drejtuesit u konstatua se pedagogu

<p>përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>udhëheqës i temës së diplomës si dhe personeli akademik dhe ndihmës akademik i departamentit asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të realizimit të temës së diplomës.</p> <p>Strukturat përkatëse të cituara më lart, asistojnë studentët, edhe në funksion të provimit përfundimtar të diplomimit.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit EM. Kreu IV Diplomimi i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga RVJ dhe DVV, GVJ evidenton se, për përgatitjen e procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti DM, bazuar në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, përcakton kategoritë e lëndëve që duhet të përmbajë provimi përfundimtar. Në bashkëpunim me stafin akademik, përgjegjës për mbulimin e këtyre lëndëve, sipas rregullore hartojnë një fond pyetjesh. Komisioni përzgjedh pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe. Pesha për çdo grup pyetjesh është në përputhje me peshën e fushës/lëndëve në programin e provimit përfundimtar.</p> <p>Në RVB citohet: <i>Për programin e studimit profesional në Elektromekanikë nuk parashikohet që detyrimi përmbyllës të realizohet nëpërmjet provimit përfundimtar.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit TA</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies. Kreu VIII, neni 53</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton në planin mësimor të programit të studimit si detyrim përmbyllës temë/provim diplomimi, me 6 ECTS. Në planin mësimor janë deklaruar 30 orë në auditor (për konsultime etj).</p> <p>Studentët, të cilët punojnë një temë diplome, kanë mundësi të shfrytëzojnë bazën e të dhënave (informacion/statistika) të institucioneve të tjera, kryesisht atyre partnere me të cilët KPGJT bashkëpunon.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit EM, neni 13, shprehet qartë se <i>udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e temës dhe procesit të diplomimit.</i></p> <p>Sipas konstatimeve nga RVB, asistenca e studentit fillon që me përcaktimin e fushës së studimit dhe vazhdon me orientimin dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore. Udhëheqësi i</p>

	<p>diplomës garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisioni nëpërmjet miratimit dhe vlerësimit me shkrim për prezantim përpara komisionit. Vlerësimi i pedagogut udhëheqës është një element i rëndësishëm në vlerësimin me notë të studentit prej komisionit.</p> <p><i>Ref: Evidenca 26.1 Plani mësimor EM</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit EM</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>N/A</p> <p><i>Programi i studimit Elektromekanikë ka filluar në vitin 2022-2023 dhe temat e diplomës do të mbrohen nga studentët në fund të vitit akademik 2023-2024.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmblyës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregulloret e KPGJT, programit të studimit EM, e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies kanë të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal.</p> <p><i>Ref: Evidenca 6 Rregulloret e departamentit, KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 7 Rregullorja e Programit të Studimit EM</i> <i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ nga DVV evidenton se Programet profesionale 2 vjeçare të studimit, jouniversitare, realizohen me 120 kredite. Kohëzgjatja normale është 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tyre do të lëshohet “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.</p> <p>Modeli i Diplomës është i miratuar me vendim të Senatit Akademik të KPGJT. Në bazë të Udhëzimit të MAS, nr. 10, datë 30.03.2020, i ndryshuar, regjistrimi i formës së diplomës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave do të kryhet pas akreditimit të programit të studimit.</p> <p>Diploma e Programit të studimeve në Elektromekanikë shoqërohet me listën e notave, ku pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde dhe një kopje zyrtare të programit të studimit të zhvilluar.</p>

	<p>Në RVB thuhet: Për diplomat profesionale 2 vjeçare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës. Ndërkohë në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 55 është <i>Suplementi i Diplomës</i>.</p> <p>GVJ konsultoi Vendimin i KM nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar dhe në të nuk përmendet (por nuk përjashtohet) lëshimi i detyruar i suplementit dhe pajisjen e studentit me këtë dokument shumë të rëndësishëm akademik (sidomos për ‘transparencën’ ndërkombëtare). Prandaj GVJ mendon se lëshimi i suplementit të diplomës (në dy gjuhë) duhet si shoqërues i domosdoshëm i diplomës profesionale, sidomos kur diploma kalon në procedurën e njohjes në një institucion njohje/ekuivalentimi (NARIC) jashtë Shqipërisë. Ka IAL në Shqipëri siç është UAMD që e lëshon këtë dokument.</p> <p>Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (sipas ligjit 80/2015, neni 91).</p> <p><i>Ref: E 25 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i> <i>Ref: Evidenca 48 Modeli i Diplomës</i> <i>Ref: Evidenca 49 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e modelit të Diplomës</i> <i>Ref: Evidenca 50 Lista e notave, model</i> <i>Ref: Vendim i KM nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstatoi se: KPGJT mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës të KPGJT.</p> <p>Në lidhje me ecurinë e studentëve KPGJT zbaton legjislacionin duke hedhur të dhënat në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e Diplomave. KPGJT ruan për një periudhë të pacaktuar (përgjithmonë) kopje të dokumentacionit të studentit.</p> <p>GVJ evidenton se: <i>Programi i studimit “Elektromekanikë” është në vitin e dytë të implementimit të tij, dhe ende nuk ka të diplomuar ndonjë student, që të hidhet në regjistrin e diplomave.</i></p> <p><i>Nga takimi me sekretarinë mësimore GVJ konstaton se KPGJT</i></p>

<p><i>muk ka Rregullore të sekretarisë.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 4 Statuti i KPGJT, neni 48</i> <i>Ref: Evidenca 51 Regjistri baze themeltar</i> <i>Ref: Evidenca 52 Regjistri i arritjeve akademike</i></p>				
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • GVJ konstaton se KPGJT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. • Në rregullore janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen, hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit, etj. • Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me Diplomë Profesionale, me listën e notave dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit i vihet në dispozicion. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Referuar Planit Strategjik të KPGJT-së 2023-2028, Kolegji synon që të krijojë një sërë vlerash institucionale, të cilat do të pasurojnë infrastrukturën akademike dhe atë institucionale në përgjithësi. Kjo do të ndihmojë në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> <p>GVJ evidentoi nga RVB dhe takimet me stafin e studentët se: në funksion të natyrës së lëndës /modulit përdorin metoda inovative të mësimdhënies, duke futur platforma simulimi, si p.sh përdorimi i platformës ELECTUDE, nëpërmjet të cilës bëhet spjegimi i tematikave të ndryshme sipas standardeve të aplikuar në shumë vende të Europës https://kpgjt.edu.al/electude/.</p> <p>Kjo platformë është krijuar posaçërisht për studentët e teknologjisë së automjeteve dhe të elektromekanikës. Nëpërmjet saj mësimi bëhet dinamik, efektiv, i shpejtë dhe shumë më tërheqës. Me ndryshim të teknologjisë, "Electude" përshtatet në kohë reale. Qëllimi i Electude është mësimdhënie dhe mësimnxënie bazuar në simulimin e-learning.</p>

CeKy shles

Zf

	<p>Përveç kësaj platforme, pedagogët përdorin demonstrime në video, apo makete për konkretizimin dhe paraqitjen vizuale të funksionimit të sistemeve të ndryshme të automobilimit.</p> <p><i>Ref: Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me drejtues, GVJ konstatoi se KPGJT operon në disa nivele të shqyrtimit dhe monitorimit të personelit të tij për të garantuar cilësi dhe profesionalizëm në çdo proces. Vlerësimi i aftësive të personelit kryhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Nga eprori direkt, ku pedagogu i nënshtrohet vlerësimit në formën e kontrolleve të herë pas hershme gjatë procesit mësimor si dhe vëzhgimit të punës mësimore në përshtatshmëri me syllabuset; b) nga studentët, kryesisht me anë të pyetësorëve, duke garantuar anonimatin e tyre; c) aplikimin e kontrollit paralel të personelit akademik me pak përvojë nga personel akademik me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie; d) zyra e NjBSC, që duke vlerësuar rëndësinë që ka mendimi i stafit, ka ndërmarrë zhvillimin e një pyetësori. <p>NJSBC është një strukturë e krijuar në KPGJT, me Vendim Rektori nr.3, datë 28.08.2023.</p> <p><i>Ref: Evidenca 4 Statuti KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 22 Vendim Rektori për krijimin e NJSBC</i> <i>Ref: Evidenca 18 Analiza vjetore 2022-2023</i> <i>Ref: Evidenca 24 Mendimet e studentëve – pyetësori i NjSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas RVB e takimet e zhvilluara, GVJ konstatoi se NjBSC, si strukturë përgjegjëse, informon drejtuesit e Departamenteve, e përmes tyre të gjithë stafin e KPGJT, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe anëtarëve të personelit.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 janë kryer dy sondazhe, të cilat janë përpunuar dhe mbi bazë të tyre përpilohet prej NJSBC Raporti i Analizës së Pyetësorëve e cila i përcillet Rektorit dhe njësisë bazë; kjo bëhet subjekt i një konsultimi të gjerë me stafin akademik.</p>

	<p><i>Ref: Evidenca 23 Rregullore NjSBC</i> <i>Ref: Evidenca 53 Informim i dep. mbi veprimtarinë e NJSBC</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ eidenton mbi bazën e DVV dhe vizitës në KPGJT se Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë ndihmon stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminare apo forume të ndryshme që i aftësojnë ata në metoda të mësimdhënies si dhe formimit të tyre akademik. KPGJT ka hartuar një plan për zhvillimin e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të tyre në fushën e mësimdhënies, si dhe për mbështetje e motivim në kërkimin shkencor.</p> <p>Për shkak se Institucioni ofron programe 2-vjeçare me karakter profesional, fokusi është në kërkimin e aplikuar. Puna kërkimore e personelit akademik përcaktohet nga Departamenti në kuadër të akteve rregullatore të KPGJT.</p> <p>KPGJT nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie, mbështet të gjitha punimet në fusha të praktikës, botimeve, artikujt shkencorë apo projekteve që stafi akademik ndjek gjatë kohës që është i angazhuar në procesin mësimor.</p> <p><i>Ref: Evidenca 36 Plan për zhvillimin e personelit akademik</i> <i>Ref: Evidenca 42 Leksione të hapura</i> <i>Ref: Evidenca 43 Veprimtari të stafit në kuadër të trajnime</i> <i>Ref: Evidenca 62 Pagesa për mobilitete të stafit KPGJT</i></p>			
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ konstaton se KPGJT ndjek një politikë që promovon cilësinë në mësimdhënie.</i> • <i>Vlerësimi i aftësive të personelit lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor kryhet: a) nga eprori direkt, b) nga studentët, c) nga kontrollit paralel i personelit akademik me pak përvojë nga personel akademik me eksperiencë të gjata në mësimdhënie dhe nga d) zyra e NjSBC.</i> • <i>Institucioni ka hartuar një plan për zhvillimin e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të tyre në fushën e mësimdhënies, si dhe për mbështetje e motivim në kërkimin shkencor.</i> 				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1																																						
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																						
Kriteret	Vlerësimi																																					
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>GVJ nëpërmjet dokumentave, tabelave dhe takimeve, konstaton se personeli i KPGJT përbëhet nga personeli akademik, ndihmës akademik me karakter mësimor dhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ. Personeli i KPGJT mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme (Ref. Evidenca 4 Statuti i KPGJT; Kreu V, Neni 29). Kontrata e punës bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve (Ref. Evidenca 55 Kontrata tip e punës).</p> <p>Sipas Tabelës 1 Aneksi Stafit Akademik të dhënat për stafin që ka mbuluar programin e studimit në 2 vitet e fundit janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik për programin e studimit “Elektromekanikë”</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr./Akademik</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc. Dr.</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>ME/MSc</td> <td>2</td> <td>9</td> <td>2</td> <td>1/11</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>4</td> <td>14</td> <td>5</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se 1 nga anëtarët e personelit akademik kanë titullin Prof. Dr./Akademik, 1 anëtar Prof/ Asoc, 1 anëtarë Dr. ndërsa 2 të tjerët janë me Msc. në përputhje me kriteret që kërkohen për mbulimin e lëndëve/moduleve të programit profesional të studimit 2 vjeçar në “Elektromekanikë” (sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit</p>				Stafi akademik për programin e studimit “Elektromekanikë”	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr./Akademik	1	3	1	3	Prof. Asoc. Dr.	1	-	1	2	Dr./PhD	-	2	1	2	ME/MSc	2	9	2	1/11	Totali	4	14	5	19
Stafi akademik për programin e studimit “Elektromekanikë”	2022-2023		2023-2024																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK																																		
Prof. Dr./Akademik	1	3	1	3																																		
Prof. Asoc. Dr.	1	-	1	2																																		
Dr./PhD	-	2	1	2																																		
ME/MSc	2	9	2	1/11																																		
Totali	4	14	5	19																																		

	<p>pasardhës, pra BSc.). Ato kanë edhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p><i>Ref: Tabela përmbledhëse, Aneksi 1</i> <i>Ref: Evidenca 57 Procedura e Rekrutimit të Punonjësve në KPGJT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ eidenton se sipas Evidenca 54 Realizimi i ngarkesës për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa për stafin akademik efektiv është nga 120 - 250 orë dhe pjesa tjetër është realizuar nga stafi akademik me kontratë (sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, pika II. 1, i ndryshuar me Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 e Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018) ngarkesa për asistent-lektorë me Msc. është 195 orë, por mund të realizojë edhe 200 orë suplementare në auditor. Për autoritetet drejtuese Rektor është 50 orë, Drejtues departamenti është 90 orë).</p> <p><i>GVJ vlerëson edhe numrin e lëndëve në semestër që zhvillon personeli akademik e cila është konform Udhëzimeve të sipërcituara dhe PAE lejohen deri në 3 tre lëndë semestrare.</i></p> <p>Ndërkohë në këto lëndë nuk është llogaritur praktika profesionale që këto pedagogë kanë si veprimtari shtesë në ndjekjen e studentëve.</p> <p>Sipas RVB e DVV, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv (PAE), për vitin akademik 2022-2023 përbën afro 40.6% të ngarkesës mësimore që parashikohet për vitin e parë të këtij program studimi. Sipas legjislacionit në fuqi raporti i ngarkesës PAE : PAK duhet të jetë 70% : 30%. Për këtë GVJ sygjeron shtimin e personelit akademik efektiv.</p> <p><i>Ref: Evidenca 54 Realizimi i ngarkesës për vitin akademik 2022-2023</i> <i>Ref: Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Elektromekanikë në vitin akademik 2022-2023</i> <i>Ref: Tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në</p>	<p>GVJ konstaton se në periudhën 2022-2024 KPGJT ka treguar qëndrueshmëri të personelit akademik. Në 2 vitet e fundit personeli akademik është i njëjtë dhe janë plotësuar me staf akademik të ri sipas lëndëve dhe programeve të studimit të</p>




<p>programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>hapura gjatë këtyre dy viteve. Pra, Institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Institucioni e konsideron qëndrueshmërinë e stafit si një faktor kyç të suksesit për shkak të [cit]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Cilësia në përzgjedhje dhe përputhja e eksperiencës me lëndët</i> 2) <i>Respektimi i dyanshëm i kontratës. KPGJT respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për personelin</i> 3) <i>Institucioni siguron raporte midis kategorive të personelit akademik, moshës, eksperiencës, etj., dhe shkëmbimin e eksperiencës midis brezave.</i> <p><i>Ref: Evidenca 4 Statuti i KPGJT; Kreu V, Neni 29</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 55 Kontrata tip e punës</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 56 Pagesat e kontributeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i bashkëngjitur dhe nga takimi në Zyrën e BNj, GVJ konstaton se KPGJT ka përcaktuar politika të qarta të rekrutimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, referuar dhe Statutit dhe Ligjit të AL. GVJ konstaton se stafi përzgjidhet me procedurë selektimi dhe intervistimi (sipas Procedurës të punësimit për personeli akademik, ndihmës akademik me karakter mësimor dhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ të Burimeve Njerëzore). Propozimet për staf të ri burojnë nga Departamenti, i cili propozon profilin akademik dhe profesional të kandidatit. Aprovimin final e bën Rektori.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik i nënshtrohet praktikave të përcaktuara përkundrejt aplikimit me dosje dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve, që realizohet nga ZBNj bëhet me seleksionim paraprak, intervistë dhe duke zhvilluar orë të hapura leksioni, në praninë e komisionit të rekrutimit. Kriteret përcaktohen nga Departamenti i Mekanikës, mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga Komisioni i Rekrutimit (për personelin</p>



	<p>akademik si rregull përbëhet nga: Administratori, Rektori, Drejtuesi i ZBNj, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe sipas rastit pedagogë nëse gjykohet e nevojshme).</p> <p><i>Ref: Evidence 4 Statuti i KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit</i> <i>Ref: Evidence 28 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 57 Procedura e Rekrutimit të Punonjësve në KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 58 Praktikë aplikim për punësim</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, tabelave të përmbledhura dhe takimeve në institucion rezulton se Departamenti i Mekanikës ka 1 një personel ndihmës akademik.</p> <p><i>GVJ konstaton se personeli akademik/administrativ përzgjidhet me konkurs dhe vlerësimi bëhet në bazë të përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe ekspertizës profesionale.</i></p> <p>Nisur nga natyra e KPGJT dhe programeve që ai ofron, një rëndësi të veçantë në procesin e rekrutimit i jepet atyre kandidatëve të cilët kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe janë unikë në fushën e tyre të specializimit.</p> <p><i>Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit</i> <i>Ref: Evidencë 57 Procedura e Rekrutimit të Punonjësve në KPGJT</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik</p>	<p>GVJ konstatoi në evidencat në Departamentit të Mekanikës, si dhe në vizitat në institucion se KPGJT mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë të gjithë anëtarët e personelit akademik të programit të studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Spektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me personelin akademik me kohë të plote dhe të pjesshëm.</p> <p>Përveç angazhimit në mësimdhënie në auditor, personeli akademik ka për detyrë të mbikqyrë studentët gjatë zhvillimit të praktikës mësimore. Në fund të çdo semestri paraqitet ngarkesa e realizuar për çdo anëtar stafi.</p>

dhe administrativ.	<p><i>Ref: Evidencë 59 Organigrama</i> <i>Ref: Evidencë 54 Realizimi i ngarkesës për vitin akademik 2022-2023</i> <i>Ref: Evidencë 55 Kontrata tip e punës</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se Institucioni ka garantuar që përveç laboratoreve të programit të studimit në dispozicion për procesin akademik, për pjesën e praktikës profesionale të vitit të dytë të sigurojë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Nga Tabela e bashkëpunimeve rezultojnë këto të dhëna: Marrëveshje në kuadër të institucionit dhe 11 Marrëveshje në kuadër të vetë programit Elektromekanikë.</p> <p>KPGJT/DM, në marrëveshje dhe bashkëpunim me biznese e kompani, vë në dispozicion personelin e kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Personeli ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me personin mbikqyrës të studentit të caktuar nga subjekti pritës.</p> <p><i>Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit</i> <i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i> <i>Ref: Evidencë 19 Marrëveshje bashkëpunimi me IAL</i> <i>Ref: Evidencë 14 Marrëveshje bashkëpunimi me bizneset</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga DVV, GVJ konstaton se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me KPGJT dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Në fund të praktikës profesionale studentit përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojë në subjektin pritës. Elementët përbërës të dosjes së vlerësimit të studentit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Raporti përfundimtar i studentit; Vlerësimi i pedagogut që ndjek zhvillimin e praktikës nga studentit; Vlerësimi i personit mbikqyrës të caktuar nga institucioni /subjekti pritës. <p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës, e ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tij/tyre për</p>

	praktikën profesionale. Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit			
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> GVJ vlerëson që personeli akademik dhe ndihmës-akademik që mbulon programin e studimit profesional “Elektromekanikë”, përmbush standardet për kualifikimin e duhur dhe të posaçëm akademik e profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës akademik me karakter mësimor, personelit ndihmës akademik me karakter administrativ në KPGJT bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë. GVJ konstatoi se KPGJT mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Institucioni ka garantuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Nga Tabela e bashkëpunimeve rezultojnë 11 Marrëveshje në kuadër të vetë programit Elektromekanikë. Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se KPGJT dhe programi i studimit 2-vjeçar “Elektromekanikë” ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike/laboratorike. Nga vizita në këtë institucion dhe dokumentacioni në Departamentin e Mekanikës, rezultojnë se KPGJT në funksion të veprimtarisë mësimore ka këto mjediset: 4 auditor leksionesh, 4 klasa seminaresh, 4 salla për praktikë lëndore/profesionale, 3 laboratorë + 1 ofiçinë, 1 laborator IT, 1 sallë për aktivitete promovuese, 1 bibliotekë, sallë interneti (holli i katit të parë), zyra, 1 mjedis shlodhës, nyje hidrosanitare, mjediset për stafin zyra, sallë mbledhjesh, etj. Normativa sipërfaqe/për student është sipas udhëzimeve 5 m ² /student.

	<p>Laboratorët e KPGJT në shërbim të programit të studimit janë: Laboratori i Automjeteve - Transmisionet, Sistemi i Frenimit dhe Sisteme të Tjera; Laboratori i Motorëve dhe Sistemit të Ushqimit të Automjeteve; Laboratori i Sistemeve Elektrike dhe Sistemit të Kondicionimit.</p> <p>Nga pikëpamja funksionale GVJ konstaton se hapësirat akademike janë të reja, plotësojnë kushtet në aspektin e lartësisë, ndriçimit dhe ajrosjes. Mësimi organizohet në grupe mësimorë në përputhje me parashikimet ligjore për këtë natyrë programi studimi: grupe deri në 25 studentë në ushtrime, grupe me 10 -12 studentë në laboratore.</p> <p><i>Ref: Evidencë 10 Infrastruktura KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 11 Laboratorët</i> <i>Ref: Evidencë 12 Laboratorët IT</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vizitoi kabinetet dhe auditorët, ku zhvillojnë mësim studentët e programit të studimit dhe konstatoi se është bërë punë shumë e mirë për t'i pajisur sallat mësimore me mjete audio vizive si PC dhe projektorë, duke mundur përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët. Laboratorët janë ndërtuar në shërbim të këtij programi studimi dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat për zhvillimin e mësimdhënies në lëndët përkatëse. Të gjitha mjediset e KPGJT janë të pajisura me internet dhe të mbuluara me sinjal WiFi.</p> <p><i>Ref: Evidencë 10: Infrastruktura KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 12: Infrastruktura IT</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ vizitoi auditoret dhe laboratorët e programit të studimit "Elektromekanikë" si dhe laboratorët e tjerë që përdoren nga studentët e këtij programi profesional, dhe konstatoi se për këtë program studimi janë në dispozicion 3 laboratorë + 1 oficinë.</p> <p>Këto laboratorë dhe oficina janë ndërtuar në shërbim të këtij programi studimit dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p> <p><i>Ref: Evidencë 10: Infrastruktura KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 11: Laboratorët e KPGJT</i> https://kpgjt.edu.al/laboratori/</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion dhe DVV, KPGJT disponon 1 laborator informatike, me 42 poste pune secili, të mirëpajisur me kompjutera, që përdoret sipas nevojave. Në kompjuterat instalohen programe profesionale sipas natyrës së programit Elektromekanikë.</p> <p><i>Ref: Evidenca 34/1 - Infrastruktura IT</i></p>
---	---

Konkluzione

- *GVJ vlerëson që Kolegji Profesional Gjerman i Tiranës ka vënë në dispozicion të programit të studimit “Elektromekanikë” mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik, të posaçëm për natyrën inxhinierike të automjeteve, etj.*
- *Aktiviteti mësimor zhvillohet në kabinetet dhe auditorët, të pajisur me mjete audio vizive si PC dhe projektorë, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët.*
- *Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse (fizike dhe elektronike), e vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe / ose në gjuhë të tjera të huaja (kryesisht anglisht). Kjo literaturë është vendosur edhe në syllabuset përkatëse nga personeli akademik. Literatura e rekomanduar synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit “Elektromekanikë”.</p> <p><i>GVJ evidenton se për arsye të vështirësive të hartimit të teksteve shkollore për lëndët, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve mbulohet nga literatura e përgatitur nga vetë stafi, në formën e cikleve të leksioneve, në përputhje me temat në syllabuset përkatëse. Këto materiale janë vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekën e KPGJT.</i></p> <p>Studentët përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund</p>

	<p>të shfrytëzojnë edhe platformat online si Microsoft Teams dhe Google Classroom, të cilat i japin akses studentëve edhe në literaturë sipas lëndëve përkatëse që zhvillojnë.</p> <p><i>Ref: Evidenca 35 Syllabuse EM</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KPGJT ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e vendosur në godinën e institucionit, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit, e cila funksionon mbi bazën e një rregullore. <i>Biblioteka zotëron një fond modest librash me rreth 100 tituj, të cilët janë bashkëkohorë.</i></p> <p><i>Ref: Evidence 60 Fondi e Librave të Bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentat dhe vizita në institucion rezulton se Biblioteka e KPGJT është e pasur në numër të konsiderueshëm botimesh të viteve të fundit. Kontigjenti i librave ka ardhur nga blerjet të financuara nga KPGJT, donacioneve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palë të treta, etj, si edhe nga projektet të ndryshme.</p> <p>Meqenëse KPGJT ka vetëm 2 vjet që ka filluar aktivitetin akademik nevojat për literaturë ndihmëse, mbulohen edhe nga fondi personal i literaturës që disponojnë pedagogët, qoftë ky fond fizik ose digjital.</p> <p>Nga DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit, studentëve, personelit akademik. Të gjitha materialet që rekomandohen në syllabuset e lëndëve janë pjesë e bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KPGJT ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit “Elektromekanikë sipas adresave të krijuara nga çdo pedagog.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo ofron të gjitha kushtet logjistike dhe ergonomike, është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe me pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin për të gjithë studentët.</p> <p>Biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi</p>

<p>vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Salla me fond të hapur është komode dhe në shërbim të plotë të studentëve, personelit akademik etj, çdo ditë të javës nga e Hëna-Premte 09:00-14:00, kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.</p> <p><i>Ref: Evidence 60/1 regjistrat e menaxhimit te fondit të librave</i></p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se KPGJT bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Përgjegjësit e programit të studimit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve.</p> <p>Në mënyrë sistematike kërkohet nga pedagogët që leksionet, librat apo botime të depozitohen në bibliotekë.</p>			
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ konstaton se programi i studimit Elektromekanikë përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar. Ajo është në mbështetje të mësimdhënies.</i> • <i>KPGJT ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedise të posaçme, shlodhëse dhe rekreative.</i> • <i>GVJ konstaton që KPGJT ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar.</i> • <i>KPGJT ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit "Elektromekanikë". Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.</i> 				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në sekretari, GVJ u informua që institucioni ka krijuar sistemin kompjuterik të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administron të dhënat / database për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i databazës kompjuterike është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Çdo informacion nga sekretaria mësimore ju dërgohet stafit dhe studenteve dhe shoqërohet me shkresa përkatëse sipas procedurave të KPGJT të përcaktuara në rregulloret e tij.</p> <p><u>GVJ i rekomandon</u> Institucionit vënien në përdorim të një platforme (sistemi on-line) për përdorim nga sekretaria, stafi, studentët me akses të dedikuar, sipas detyrave të tyre (regjistrimin e të dhënave të studentëve nga sekretaria; hedhje notash, materialesh mësimore nga stafi; lexim notash nga studentët, etj).</p> <p><i>Ref: Evidencë 4 Statuti i KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 51 Regjistri themeltar i studentit</i> <i>Ref: Evidencë 52 Regjistri i arritjeve akademike</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ nga takimi me personelin e KPGJT konstatoi se Sektori i burimeve njerëzore, protokollit dhe arkivës administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Punonjësi i burimeve njerëzore, menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve si dhe plotëson rregjistrin themeltar. Ndjek procedurat për kontratat e punës për të gjithë punonjësit e KPGJT. Hedh të dhënat e çdo punonjësi në rregjistrin themeltar. Nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen, bazuar në ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale.</p>

	<p>Departamenti, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrativ, sipas akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrare dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton planet mësimore kalendarike dhe marrëveshjen e punës, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Punonjësi i burimeve njerëzore, siguron dhënien dhe marrjen e informacioneve e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit në Elektromekanikë dhe programet e tjera. Stafi akademik, ndihmës akademik dhe ai administrativ informohen dhe njihen me të gjithë dokumentacionin, të brendshëm ose të jashtëm, të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve në realizimin e programit të studimit. Zyra e protokollit shpërndan dokumentacionin sipas destinacioneve të përcaktuara.</p> <p>Departamenti i Mekanikës, nëpërmjet këshilltarëve akademik, ose përgjegjësit të departamentit, informohen për të gjitha procedurat dhe rregulloret e brendshme në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor. Përdorimi i platformës Classroom, i grupeve të përbashkëta në aplikacione të ndryshme bën të mundur informimin e shpejtë të studentëve për dinamikat e ndryshimeve ditore apo javore.</p> <p>Pjestarët e stafit dhe studentët kanë mundësinë të përditësojnë dokumentacionin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi kompjuterik i sekretarisë mësimore operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundur shërbimet e nevojshme.</p> <p><i>GVJ konstaton se KPGJT nuk ka ndonjë platformë për menaxhim të integruar të dokumentacionit. Në KPGJT përdoren softuerë të përgjithshëm të paketës microsoft, për regjistrim të dhënash dhe përpunim të tyre. Por forma zyrtare e këtyre regjistrimeve mbetet ajo në letër.</i></p> <p>Sekretaria mësimore e KPGJT mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish: Zyra IT, Përgjegjës Departamenti, Sekretare, Studentë, Pedagog, Rektor, etj., përmes një sistemi kompjuterik (databaze elektronike) që ndihmon procesin</p>




	mësimor në të gjithë komponentët.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Siç është shkruar më lart, bazuar në RVB dhe dokumentat në DVV, GVJ konstaton se KPGJT ka në përdorim platforma dhe module të veçanta që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Platforma Microsoft Teams dhe Google Classroom ndihmojnë për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga takimet në Institucion dhe nga DVV konstatojmë se sistemi kompjuterik i sekretarisë mësimore në KPGJT, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë ka në funksion faqen zyrtare të internetit (www.kpgjt.edu.al dhe info@kpgjt.edu.al), në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, apo të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë kombëtar e ndërkombëtar. Informacioni i faqes zyrtare të internetit azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme nga personat përgjegjës në përputhje me Politikën e Mirëmbajtjes së faqes së internetit.			
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> • GVJ konstaton se KPGJT disponon një sistem kompjuterik (databaze) të sekretarisë mësimore që menaxhon e administron të dhënat e studentëve për programin e studimit EM. • Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i databazës elektronike është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi. • GVJ konstaton se KPGJT nuk disponon një sistem (platformë on-line) për menaxhim të integruar të dokumentacionit. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjene studentëve

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se KPGJT zbaton kërkesat ligjore duke raportuar çdo vit akademik pranë MASR lidhur me veprimtarinë e tij, që përfshin edhe tarifat e shkollimit, administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe jo të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p><i>Mbështetur në këtë raport për vitin 2022-2023 të aksesuar në DVV, GVJ evidenton se KPGJT është IAL private me vetëfinancim. Në burimet financiare të KPGJT përfshihen: tarifat e shkollimit, projekte/grante ndërkombëtare, financimet nga ortakët e shoqërisë “Kastrati shpk”, në cilësinë e pronarit, të ardhurat nga shërbimet që IAL ofron për të tretë dhe burime të tjera të ligjshme. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, struktura përgjegjëse për financat e KPGJT ndër të tjera harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të vitin pasardhës si dhe harton buxhetin afat mesëm, i cili mbulon një periudhë tre vjeçare, çka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p> <p>www.kpgjt.edu.al dhe info@kpgjt.edu.al</p> <p><i>Ref: Evidenca 61 Plani financiar. Buxheti</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet</p>	<p>Sipas RVB, Buxheti financiar hartohet çdo vit. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë.</p> <p>Pasqyrat financiare të KPGJT që përmbajnë: financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura, etj miratohen nga Bordi i</p>



<p>financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Administrimit.</p> <p>Siç është shkruar edhe më sipër, në raportet vjetore jepet një analitikë e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. Ky raport paraqitet prej Administratorit të universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit dhe analizohet përfundimisht nga Asambleja e ortakëve.</p> <p><i>Ref: Evidenca 62 Pagesa për mobilitete të stafit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Siç deklarohet edhe në RVB: <i>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPGJT, i cili është një urë komunikimi dhe me Bordin e Administrimit.</i></p> <p>Në RVB deklarohet se <i>KPGJT, si një institucion privat i nënshtrohet auditit financiar që kryhet nga sektori i auditimit të Shoqërisë "Kastrati".</i></p> <p><i>GVJ konstaton se deri tani nuk është kryer ndonjë auditim, por është bërë planifikimi financiar dhe raportimi vjetor financiar.</i></p> <p>Planifikimi financiar i KPGJT përmban tabelat për të ardhurat që parashikohet të krijohen si dhe planifikimin e ndarjes së burimeve financiare, të cilat janë të detajuara për çdo vit dhe të miratuara nga organet kolegjiale dhe asambleja e ortakëve. KPGJT ka hartuar planin financiar për periudhë 10 vjeçare 2022-2031, si dhe planin financiar tre vjeçar për periudhën 2022-2024.</p> <p><i>Ref: Evidencë 61 Planet financiare afatgjatë dhe afatmesëm</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 61/1 Raporti financiar për vitin 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Siç deklarohet në RVB, por edhe nga takimet me drejtuesit e IAL, konstatohet se Raportet e analizës financiare hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p><i>Ref: Evidencë 61 Planet financiare afatgjatë dhe afatmesëm</i></p>

	<i>Ref: Evidencë 61/1 Raporti financiar për vitin 2022</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KPGJT deklaron se ka garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon se ka mundur për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. KPGJT shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. Me qëllim mirë-menaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vetë institucionit.</p> <p>KPGJT llogarit koston për të gjithë institucionin sipas metodologjisë standard, që ka për bazë llogaritjen e shpenzimeve në total/ shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament.</p> <p><i>GVJ vlerëson se ky program plotëson ose është afër kuotave të planifikuara të studentëve dhe kjo gjë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, duke qenë se të ardhurat kryesore vijnë nga tarifat e studimit.</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 61 Plani financiar, Buxheti</i></p>

Konkluzione

- *GVJ vlerëson se KPGJT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit "Elektromekanikë" dhe mbështetjen e studentëve.*
- *KPGJT zhvillon aktivitetin si institucion privat i arsimit profesional të lartë dhe çdo vit harton një raport financiar të gjendjes financiare të shoqërisë dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
- *KPGJT, si një institucion privat i nënshtrohet auditit financiar që kryhet nga sektori i auditimit të Shoqërisë "Kastrati". GVJ konstaton se deri tani nuk është kryer ndonjë auditim, por është bërë planifikimi financiar dhe raportimi vjetor financiar.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>KPGJT, Departamenti i Mekanikës kanë hartuar kuadrin ligjor si rregullore, udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimin e dijeve/ankimimin dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e institucionit. KPGJT kujdeset edhe për studentët pas diplomimit.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KPGJT zhvillohet në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet përkatëse.</p> <p>I gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, i transmetohet studentëve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me guida, manuale, rregullore të cilat i vihen në dispozicion studentëve; informacione të shpallura si orari, njoftime, etj; - Informacione në format elektronik, ku burimi kryesor mbetet faqja eëbsite e KPGJT dhe komunikimi me email; - Takime të drejtpërdrejta të studentëve, apo grupit mësimor. <p><i>Ref: Evidencë 4 Statuti i KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 17 Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 7 Rregullore e programit të studimit në TA</i> <i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe</p>	<p>Politikat dhe procedurat në hyrje në KPGJT, garantojnë barazinë</p>

<p>procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, sepse bëhen <i>nëpërmjet</i> Maturës shtetërore dhe U-albania që është ngritur mbi politikën <u>meritë-preferencë</u> të kandidatëve për studentë.</p> <p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, të ndjekura nga KPGJT, janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ato kanë garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë duke përfshirë dhe studentët e programit të studimit “Elektromekanikë”. KPGJT si Kolegj profesional ofron vetëm programe profesionale, dhe sipas ligjit nuk ka kusht kusht të notës mesatare për kandidatët.</p> <p><i>Ref: Evidencë 4 Statuti i KPGJT</i> <i>Ref: Evidenca 7.1 Rregullore e programit të studimit në EM.pdf</i> <i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB e DVV, kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi për Kolegjin Profesional Gjerman të Teknologjisë, për çdo vit akademik përcaktohen me Vendim Senati Akademik.</p> <p>Sipas akteve ligjore në fuqi, KPGJT ka detyrimin e dorëzimit të kriterëve të pranimit të studentëve dhe të kuotave përkatëse çdo vit akademik pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo program në përputhje me kapacitetet që disponon institucioni dhe që i nënshtrohen verifikimit nga kjo ministri. Pas miratimit këto vendosen në portalin U-Albania.</p> <p>GVJ konstaton se KPGJT përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron, nëpërmjet shpalljeve në ambientet e tij dhe të publikimit në faqen e internetit të KPGJT, si edhe informimit nëpërmjet uebsite, rrjeteve sociale, etj. Informimi dhe ndërgjegjësimi për t’u regjistruar në KPGJT realizohet në përputhje me politikat dhe strategjinë e tij, nëpërmjet këtyre formave: takimeve informuese me nxënësit e shkollave të mesme, shpërndarje e fletëpalosjeve, postera, broshura, etj, dalje publike të përfaqësuesve të KPGJT në media dhe /ose në panaire e evente të ndryshme, etj.</p> <p><i>Ref: Evidenca 63 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve/kuotave</i></p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se në të gjitha strategjitë, rregulloret ku përfshihen kriteret/procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë shkruar në gjuhë të kuptueshme për studentin dhe janë të publikuara në faqen elektronike të KPGJT. Ato janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe publiku.</p> <p>Faqja zyrtare përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPGJT, programet mësimore, shërbimet, pranimet dhe kriteret e pranimit, aktet rregullatore të Institucionit, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Menaxhimit të faqes së Internetit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik KPGJT dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar. Procedura e pranimit bëhet sipas udhëzimit të MAS.</p> <p>Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave është përcaktuar qartë në Statutin e KPGJT dhe në rregulloren e programit të studimit Elektromekanikë.</p> <p>https://kpgjt.edu.al/wp-content/uploads/2023/08/Veprimtaria-Pergjegjesia-Sociale-KPGJT-small.pdf</p> <p><i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i> <i>Ref: Evidencë 17 Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit</i> <i>Ref: Evidenca 64 Tabela e shpërndarjes së kuotave</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Sipas RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se: KPGJT ka objektiv të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel kombëtar dhe rajonal, për këtë synon që të ofrojë shërbimet e tij në formë cilësore dhe efikase, duke e vënë theksin tek e drejta për arsim si një e drejtë kushtetuese dhe duke i kushtuar rëndësi përgjegjësisë sociale.</p> <p>KPGJT për shtresat e marginalizuara dhe kandidatët me aftësi të veçanta përcakton kuota specifike, të ndara nga kuotat kryesore. Renditja e tyre bëhet brenda kuotave të parashikuara për këtë shtresë.</p> <p><i>GVJ konstaton se për studentët e pakicave romë dhe ballkano-egjiptiane, KPGJT ka bërë parashikime në kuota, por nuk ka pasur raste të tilla.</i></p>

	<i>Ref: Evidenca 64 Tabela e shpërndarjes së kuotave</i>
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ evidenton se një nga prioritetet e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë është të vlerësojë punën dhe meritat e çdo studenti dhe në të njëjtën kohë ta motivojmë atë. KPGJT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPGJT. Gjithashtu KPGJT ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët. <i>Ref: Evidenca 64 Tabela e shpërndarjes së kuotave</i>

Konkluzione

- GVJ vlerëson se KPGJT ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit “Elektromekanikë”.
- GVJ vlerëson si të dobishme “Politikën e procedurat e Komunikimit në KPGJT”, që sjell informimin e të interesuarve dhe transparencë.
- KPGJT si institucion privat i arsimit të lartë profesional i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga informacioni në RVB, DVV dhe nga takimet me studentë, GVJ konstaton se studentët, janë njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në çdo lëndë. Pranë KPGJT funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënive me Publikun, e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KPGJT dhe programet e studimit




	<p>që ofron si dhe orienton të interesuarit te zyrat përkatëse, Sekretaria Mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe koordinatorët, të cilët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në faqen e internetit publikohet dhe përditësohet informacion i plotë, i saktë dhe i detajuar në lidhje me portofolin dhe ofertën akademike të KPGJT.</p> <p><i>Ref: Evidenca 66 Kalendari akademik</i> <i>Ref: Evidencë 32 Orari mësimor</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuse EM</i> <i>Ref: Evidencë 17 Rregullore e Organizimit dhe Funkcionimit të KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në rregulloret e KPGJT dhe të programit të studimit ka edhe kriteret/procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjeshme.</p> <p>Për studentët që rregjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin e studimit “Elektromekanikë”, komisioni <i>ad-hoc</i> bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p> <p><i>Ref: Evidencë 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Rregulloren e KPGJT, Rregulloren e programit të studimit EM si dhe në syllabus-in e çdo lënde, të cilat vihen në dispozicion të studentëve përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i studentëve.</p> <p>Vlerësimi, i shprehur në notë dhe gërma në rregulloret ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe veçanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe studentët duhet të ndjekin.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7.1 Rregullore e programit të studimit në EM</i> <i>Ref: Evidencë 4 Statuti i KPGJT</i> <i>Ref: Evidencë 25 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KPGJT/Departamenti i Mekanikës ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Në rregullore janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome, sipas vendimit të Rektorit për çdo vit akademik.</p> <p><i>GVJ evidenton se brezi i parë i studentëve të programit Elektromekanikë do të diplomohet në vitin aktual 2023-2024.</i></p> <p>Studentët vihen në dijeni për procedurat e lidhura me provimet dhe diplomimet nëpërmjet tutoriatit, komunikimeve para provimeve me anë të postës elektronike e-maileve, sekretarisë mësimore, titullarit të lëndës dhe publikimit në mjediset e KPGJT.</p> <p><i>Ref: Evidencë 6 Rregullore e departamentit</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 7.1 Rregullore e programit të studimit në EM</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në parashikimet e Statutit, Rregullores KPGJT, detyrat funksionale dhe politikat e komunikimit, Zyra e BNJ si dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Sekretaria Mësimore, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në procesin e informimit dhe pranimit të studentëve të rinj.</p> <p>KPGJT shpërndan broshura dhe fletëpalosje informuese ku informacioni përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Për studentët e rinj, KPGJT organizon çdo vit, Javën e Orientimit të Studentëve, si dhe i vë në dispozicion studentit Paketën informuese për studentin, një përmbledhje me informacion për KPGJT. Në vijim studentët marrin informacion për shërbimet në KPGJT nëpërmjet komunikimeve me pedagogët e DM, materiale të përgatitura nga sekretaria në lidhje me çështje të ndryshme (kalendari akademik, orar mësimor, seanca sqaruese, konsulta, etj), etj.</p> <p><i>Ref: Evidence 68 Open days në KPGJT</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 69 Takime me studentet/keshillim akademik</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 70 Panairret Work and Study</i></p> <p><i>Ref: Evidence 71 Kërkese e Studentit për punësim</i></p> <p><i>Ref: Evidence 72 Paketë Informuese për studentin</i></p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ vlerëson se KPGJT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm</i> 	

ceky shley 

mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

- Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, KPGJT publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.
- Faqja zyrtare ueb është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. Institucioni informon studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.
- Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se ato informohen në fillim të vitit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit “Elektromekanikë”. Informacioni në lidhje me programin e studimit, stafin akademik që e mbështet, detyrimet e të dy palëve, etj, është detyrë e Koordinatorit të programit të studimit, pedagogëve të çdo lënde, Zyrës së BNJ, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënies me Publikun si edhe sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Ref: Evidenca 7.1 Rregullore e programit të studimit në EM</i> <i>Ref: Evidencë 69 Takime me studentët/këshillim akademik</i> <i>Ref: Evidence 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë	<p>Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet “Paketë informuese për studentin”.</p> <p>Informacioni shpallet në mjedise të dedikuara të KPGJT si edhe mundësohet përmes faqes web https://kpgjt.edu.al/programet-e-studimit/</p> <p>Për çdo lëndë, studentit i vihen në dispozicion Syllabus i lëndës,</p>

© V. Shkë 

formuese.	<p>si dhe organizohen Tutoriatet.</p> <p><i>Ref: Evidencë 72 Paketë Informuese për studentin</i> <i>Ref: Evidenca 35 Syllabuse EM</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ nëpërmjet DVV dhe takimeve konstaton se: KPGJT nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Publikun, mban kontakte të vazhdueshme me studentët për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere si dhe për t'i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës. Duke qenë se Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë është pjesë e shoqërisë “Kastrati Group”, një nga objektivat e tij është të nxjerrë specialistë të aftë për të kontribuar pranë bizneseve të kësaj shoqërie https://kpgjt.edu.al/blog/</p> <p>Njoftimet për punësim publikohen vazhdimisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • faqen e internetit të KPGJT, https://kpgjt.edu.al/mundesite-e-punesimit-dhe-internship/ • rrjetet sociale, ose/dhe iu dërgohen studentëve me anë të postës elektronike <p>Sipas RVB, evidentojmë se KPGJT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët.</p> <p>Një mundësi punësimi është praktika profesionale pranë bizneseve, që ofrojnë punësime pas mbarimit të saj.</p> <p><i>Ref: Evidence 14 Marrëveshje bashkëpunimi me bizneset</i> <i>Ref: Evidence 71 Kërkese e Studentit për punësim</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni i jep studentëve informacion të gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafit akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit; • Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Publikun që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; • Rregullores KPGJT/Rregullores së programit të studimit; • Kontratës dy palëshe që nënshkruhet midis KPGJT dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit; • Javës së Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik. <p>Drejtuesi i Departamentit mban kontakte të rregullta, njoftime</p>

	<p>elektronike me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione për aktivitetet ekstrakurrikulare, etj. Informacionet e mësipërme studentët e këtij programi studimi mund t'i gjejnë edhe në faqen web të Kolegjit https://kpgjt.edu.al/.</p> <p>Informacione të tjera lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor afishohen në vazhdim pranë Sekretarisë mësimore të KPGJT dhe në ambientet e godinës në këndin e njoftimeve.</p> <p>Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit Teams/Google Classroom.</p> <p><i>Ref: Evidence 72 Paketë Informuese për studentin</i> <i>Ref: Evidence 73 Java e Orientimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Publikun në KPGJT, krahas detyrave të tjera në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave mësimore, si dhe për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritit në tregun e punës për studentët, si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për karrierë.</p> <p>KPGJT bashkëpunon me emra të njohur të biznesit e industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura, ku realizohet praktikë aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi, të cilat ju bëhen me dije studentëve nëpërmjet komunikimeve me e-mail, njoftimeve etj. Edhe më lart është shkruar se në Dosje janë vendosur listat e bashkëpunimeve të KPGJT dhe për programin e studimit ku janë listuar 11 të tilla.</p> <p><i>Ref: Evidence 14 Marrëveshje bashkëpunimi me bizneset</i> https://kpgjt.edu.al/blog/</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ vlerëson se KPGJT ka vënë në dispozicion të studentëve struktura dhe mjete për informim, orientim dhe ndihmë, përkatësisht:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Publikun që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët;</i> - <i>Stafin akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit;</i> - <i>Rregulloren KPGJT/Rregulloren e programit të studimit;</i> 	

<ul style="list-style-type: none"> - Kontratën dy palëshe që nënshkruhet midis KPGJT dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit; - Javën e Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik, etj. • GVJ vlerëson se KPGJT ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. • KPGJT informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ evidenton se Kolegji disponon statistika të plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje) mbi ecurinë e studentëve. Programi i studimit “Elektromekanikë” menaxhohet nga Sekretaria mësimore e KPGJT-së. Këto të dhëna ruhen në formë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy) në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e kolegjit. <i>Programi i studimit “Elektromekanikë” është ofruar nga KPGJT për herë të parë në vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Ref: Evidenca 4 Statuti i KPGJT</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në takime u theksua edhe roli i Sekretarisë mësimore që mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit për çdo program studimi. Sekretaria mësimore ka përgjegjësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit sensitiv që menaxhon. Ky informacion mund të aksesohet vetëm nga persona që autorizohen nga Rektori i Kolegjit. Statistikat vjetore të përpunuara nga të dhënat bazë të studentëve për çdo program

	<p>studimi pasqyrohen në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të KPGJT-së dhe i raportohen MAS. Listat e të diplomuarve do të raportohen çdo vit në QSHA.</p> <p><i>Të diplomuarit e parë të programit të studimit EM do të dalin në vitin aktual 2023-2024.</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 18 Analiza vjetore Institucionale</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Dokumentacioni ruhet në format fizik dhe elektronik sipas mënyrës së përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi dhe në rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia.</p> <p>KPGJT realizon kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim nga të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacione dhe evidencat përkatëse, që lidhen me procesin mësimor dhe veprimtarinë e studentëve. Puna e sekretarisë është objekt i kontrollit të paktën njëherë në vit nga administrata e Grupit Kastrati, e cila kryhet nën kujdesin e Bordit të Administrimit.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Databaza elektronike e sekretarisë ndihmon në lidhje me vlerësimet për çdo provim, detyrimet e studentëve, etj. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese.</p> <p>Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për këtë program studimi janë hedhur të dhënat në dy format.</p> <p><i>Ref: Evidence 4 Statuti i KPGJT, neni 13, neni 48</i> <i>Ref: Evidence 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia, neni 34</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre</p>	<p>Departamenti i Mekanikës, si njësi bazë për programin e studimit EM, në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Sekretarinë Mësimore, vlerësojnë cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për çdo program studimi. Departamenti çdo vit realizon Raportin vjetor, si pjesë e raportit vjetor të KPGJT.</p> <p>Feedback i vlerësimit të studentëve gjatë praktikës profesionale, si dhe punësimi i studentëve janë tregues që mbahet parasysh në vlerësimin e cilësisë së studentëve. Kjo nga ana tjetër vlen dhe</p>




traguesve.	për rishikimin dhe vlerësimin periodik të kurrikulës. <i>Ref: Evidencë 18: Analiza vjetore Institucionale</i>			
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> GVJ konstaton struktura të ngritura brenda institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve, mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të tyre. GVJ vlerëson se KPGJT dhe Departamenti i Mekanikës nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese. KPGJT diplomon brezin e parë të studentëve në programin Elektromekanikë në vitin akademik 2023-2024, prandaj nuk mund të flitet për të dhëna për punësim. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>GVJ konstatoi se në Statutin e KPGJT (nenet 16, 19, 42) KPGJT ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit dhe organiogramës së saj. Dy strukturat më të larta ku përfshihen studentët janë Senati dhe NJBSC.</p> <p>Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të KPGJT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e tyre.</p> <p>Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi.</p> <p><i>Ref: Evidence 4 Statuti i KPGJT</i></p> <p><i>Ref: Evidence 75 Këshilli i studentëve</i></p> <p><i>Ref: Evidence 74 Lista e antarëve të SA, KE dhe grupet e</i></p>

	<i>NJSBC</i>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KPGJT ka garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj.</p> <p>Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Senatin akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, etj.</p> <p>Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KPGJT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Në KPGJT studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim.</p> <p><i>Ref: Evidence 74 Lista e antarëve të SA, KE dhe grupet e NJSBC</i></p> <p><i>Ref: Evidencë 24 Mendimet e studentëve</i></p> <p><i>Ref: Evidence 76 Vendimet e ngritjes së grupeve të vlerësimit të brendshëm</i></p> <p><i>Ref: Evidenca 77 Praktikë e zgjidhjes së kërkesave të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në përmirësimin e programit të studimit, Departamenti ka realizuar diskutime dhe ka kërkuar sugjerime për: ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit “Elektromekanikë”, parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p> <p>KPGJT e vlerëson cilësinë e jetës studentore si një element të rëndësishëm të cilësisë së IAL. Për këtë arsye, KPGJT synon dhe investon të sigurojë një ambient sa më miqësor, të shëndetshëm dhe bashkëpunues me studentët.</p> <p>KPGJT ka përfshirë studentët në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve lëndore, duke reflektuar sugjerimet e tyre. Këto sugjerime merren në mbledhje të përbashkëta në departament, ose me pyetësorë, ose me grupe fokusimi.</p>

CVyshka *J*

	<p><i>Ref: Evidencë 18 Analiza vjetore Institucionale</i> <i>Ref: Evidencë 69 Takime me studentet/keshillim akademik</i> <i>Ref: Evidenca 17 Tutoriatet/ këshillim akademik;</i> <i>Ref: Evidence Mbledhje e Asamblesë së Personelit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ evidenton se sipas rregullores së KPGJT, neni 56, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit.</p> <p>Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p> <p>Nga takimet me studentët, GVJ konstaton se, në rast se studenti ka ankesë për vlerësimin (kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/ punë laborator, ushtrime, provim përfundimtar), në fillim e sqaron pedagogu i lëndës që e ka vlerësuar. Nëse ka përsëri paqartësi mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku të parashtrrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.</p> <p><i>Ref: Evidence 28 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPGJT</i> <i>Ref: Evidence 25 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia</i></p>			
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • GVJ vlerëson se KPGJT, me akte ligjore, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. • GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në NjBSC dhe në Senatin Akademik. • Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Kjo përfshirje realizohet me pyetësorët që realizohen çdo vit dhe për çdo lëndë, etj. 				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

cekyshka

JA

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se në orientimin dhe këshillimin e studentëve është i ndarë në dy faza: për maturanët që duan të ndjekin studimet pranë KPGJT dhe për studentët që tashmë janë regjistruar në KPGJT.</p> <p>Procedurat/aktivitetet në funksion të pritjes, orientimit, këshillimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Java orientimit të studentëve; • Faqja internetit/rrjetet sociale; <p>Strukturat në funksion të këshillimit e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave janë kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun, si për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore, etj; • Zyra e Burimeve Njerëzore; • Koordinatorët mësimore; • Struktura dhe anëtarë të stafit (në varësi nga natyra e çështjes). <p>Këto njësi/struktura kanë procedura gjithëvjetrore në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre.</p> <p>Në vijim studentët marrin informacion nëpërmjet komunikimeve me pedagogët tutor dhe nga sekretaria.</p> <p><i>Ref: Evidence 4 Statuti i KPGJT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e</p>	<p>Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet “Paketës informuese”.</p> <p>Sipas RVB e takimeve në institucion, GVJ konstaton se KPGJT ofron Tutoriatin gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët, si dhe</p>

<p>tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>përmes internetit.</p> <p>KPGJT iu ofron studenteve edhe seanca konsultuese për çdo lëndë para provimit përfundimtar nga padagogu i lëndës. Brenda javës nga momenti i daljes së rezultateve të provimit për çdo provim caktohet një orar për seancë sqaruese. Për studentët që hasin vështirësi, KPGJT ofron orë/seanca shitesë sipas kërkesës së studentëve ose kur KPGJT e gjykon të arsyeshme.</p> <p>Për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, pjesë përbërëse e të cilit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sekretaria mësimore e KPGJT – së; • Koordinator i programit të studimit në Departamentin e Mekanikës; • Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun. • Tutorët akademikë.
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga organigrama dhe nga RVB kontatojme se strukturat që kanë këtë detyrë janë: Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun dhe Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun organizon, menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe çështje të tjera të lidhura me to, si dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet për organizimin dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Kjo lidh dhe lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës dhe i shërben realizimit të këshillimit për karrierë.</p> <p>Në sistemin e informimit ndihmon edhe koordinatori i programit të studimit, i cili jep ndihmesë lidhur me ndjekjen e ecurisë së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë.</p> <p>Siç është theksuar edhe më lart pjesë e punës informuese janë edhe tutorët, faqja e internetit, etj.</p> <p>KPGJT ka organizuar disa takime të hapura me biznesin, industrinë dhe organizata etj, të cilët promovojnë mundësitë e punësimit të studentëve të KPGJT.</p> <p><i>Ref: Evidence 71 Kërkese e Studentit për punësim</i> <i>Ref: Evidence 68 Open days në KPGJT</i></p>

	<p>Ref: Evidence 72 Paketë Informuese për studentin</p> <p>Ref: Evidence 73 Java e Orientimit</p> <p>Ref: Evidence 70 Panairët Work and Study</p> <p>Ref: Evidenca 65 Lista e studentëve bursistë</p> <p>Ref: Evidenca 78 Pagesa e siguracioneve të studentëve</p> <p>Ref: Evidenca 79: Vizita të studentëve në biznese</p>
--	---

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>KPGJT nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun, do të mbajë kontakte me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, do të mbajë një database me të dhënat e çdo studenti të diplomuar, statistikën përkatëse; do të përpunojë statistika dhe gjenerojë raporte në lidhje me to për t'ua vënë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>Meqenëse brezi i parë i studentëve akoma nuk është diplomuar, ky proces nuk ka filluar të regjistrohet.</p> <p>Të diplomuarit e parë të programit të studimit EM do të dalin në vitin aktual 2023-2024.</p>
--	---

Konkluzione

- GVJ vlerëson se KPGJT ka procedurë e njësi të posaçme (Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun; Sekretaria mësimore; Zyra e Burimeve Njerëzore) për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.
- Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.
- Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Marrëdhënieve me publikun do të ndjekë studentët dhe do të mbajë të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe do të informojë organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse. KPGJT diplomon brezin e parë të studentëve në programin Elektromekanikë në vitin akademik 2023-2024, prandaj nuk mund të flitet për të dhëna për punësim.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

CE Vjoshka

JA

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Elektromekanikë” ofruar nga “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. KPGJT ka një lidhje mjaft të mirë me institucione të arsimit të lartë dhe biznese, stafi nga institucionet partnere përfshihet në aktivitete të ndryshme të kolegjit, përfshirë edhe kontributet në studimin e tregut në kuadër të hapjes së programeve të reja (Standardi II. 5, kriteri 1).
2. KPGJT si pjesë e shoqërisë Kastrati grup sh.p.k. bashkëpunon me biznese, që ofrojnë praktika profesionale dhe vizitat në terren, si pjesë e rëndësishme e programit të studimit. Vetë shoqëria Kastrati grup sh.p.k. është punëdhënës potencial i studentëve që gjatë praktikës profesionale dhe ka një rol si këshilltar në përmirësimin e programit të studimit dhe kurrikulës.
3. KPGJT zotëron infrastrukturë dhe ambiente të përshtatshme, me pajisjet e duhura për programin e studimit Elektromekanikë. Laboratorët, ofiçina e KPGJT kanë teknologji dhe pajisje moderne profesionale të cilët mundësojnë zbatimin në praktikë të dijeve teorike.
4. Në KPGJT përdorin metoda inovative të mësimdhënies, duke futur platforma simulimi, si p.sh përdorimi i platformës ELECTUDE, nëpërmjet të cilës bëhet spjegimi i tematikave të ndryshme sipas standardeve të aplikuar në shumë vende të Europës. Platforma ELECTUDE ka si qëllim mësimdhënie dhe mësimnxënie bazuar në simulimin e-learning, e cila është shumë e dobishme, e krijuar posaçërisht për studentët e teknologjisë së automobilave dhe elektromekanikës. ELECTUDE vlerësohet si praktikë e mirë e këtij institucioni (Standarti III. 1, kriteri 4 dhe standardi III. 6, kriteri 1).
5. Personeli është i kualifikuar, me karrierë akademike dhe profesionale. KPGJT dhe Zyra e Burimeve Njerëzore synojnë që stafi të jetë një kombinim i brezave dhe përvojave.
6. Veprimtaria akademike dhe administrative kontrollohet nga rregullore/urdhëra/akte rregullatore, që janë publike dhe transparente. KPGJT, DM dhe zyrat përgjegjëse synojnë të plotësojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin e tij në përputhje të kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në R.SH.” i ndryshuar dhe akteve nënligjore.
7. Institucioni ofron disa bursa për studentët me rezultate të mira dhe ata në nevojë.

Pika të dobta

1. Plani mësimor është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe plotëson kërkesat për arritjen e objektivave. Nga shqyrtimi i gjithë dokumentave rezultojnë edhe disa pasaktësi (më hollësisht brenda në raport). [(Standardi II.1, Kriteret 1 e 4, Standardi II.3, Kriteret 2)].
2. GVJ konstaton që Departamenti i Mekanikës kryen gjithashtu shërbimet e NJSBC-së duke menaxhuar sigurimin e cilësisë dhe kontrollin e cilësisë së programeve të studimit të ofruara nga i njëjti departament. [(Standardi I.3, Kriteri 2 dhe standarti III. 1, kriteri 6)].



3. GVJ ka identifikuar se institucioni nuk ka një sistem të centralizuar të menaxhimit të informacionit dhe komunikimit [(Standardi IV.4, Kriteret 1, 3)].

Rekomandime

1. GVJ rekomandon rregullimin e pasaktësive dhe përshtatjen e Kategorive të Veprimtarive Formuese (A-E) me kërkesat e VKM nr. 879/2019, duke rritur kreditet për lëndët e kategorisë B, dhe duke ulur kreditet e kategorisë C, duke i sjellë sipas kërkesave ligjore (Standardi II.1, Kriteret 1, 4).
2. GVJ rekomandon që Institucioni duhet të kontraktojë një ekspert të jashtëm për vlerësimin e cilësisë.
3. GVJ mendon se shtimi i stafëve akademike e ndihmëse nëpër departamente do të përmirësonte cilësinë e realizimit të mësimdhënies, laboratorëve, praktikave, etj.
4. GVJ rekomandon shtimin e librave të profilit të automjeteve në zërat e bibliotekës (Standarti IV. 3, kriteri 2).

Evaluation's conclusions for the professional study program "Electromechanic" provided by the "Professional College German of Technology"

Strengths and affirmations

1. KPGJT has a very good relationship with higher education institutions and businesses, staff from partner institutions are involved in various college activities, including contributions to the market study in the framework of the opening of new programs (Standard II.5, Criteria 1).
2. KPGJT as part of Kastrati group society sh.p.k., cooperates with business and institutions, which offer professional practices and field visits, as an important part of the study program. Kastrati group society sh.p.k., is a potential employer of students during professional practice and has an advisory role in improving the study program and curriculum.
3. KPGJT owns the appropriate infrastructure and facilities, with the right equipment for the Electromechanic study program. The laboratories, the office of KPGJT have modern professional technology and equipment that enable the practical application of theoretical knowledge.
4. In KPGJT they use innovative teaching methods, introducing simulation platforms, such as the use of the ELECTUDE platform, through which various topics are explained according to the standards applied in many European countries. The ELECTUDE platform aims to teach and learn based on the e-learning simulation, which is very useful, specially designed for the students of automotive technology and electromechanics.



ELECTUDE is evaluated as a good practice of this institution (Standard III. 1, criterion 4 and standard III. 6, criterion 1).

5. The personnel are qualified, with an academic and professional career. KPGJT and the Office of Human Resources aim for staff to be a combination of generations and experiences.
6. Academic and administrative activity is controlled by regulations/orders/regulatory acts, which are public and transparent. KPGJT, DM and the responsible offices intend to complete all the necessary documentation for its operation in accordance with the requirements of Law no. 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in IAL in the Republic of Albania" amended and by-laws.
7. The institution offers several scholarships to students with good results and those in need.

Weaknesses

1. The teaching plan is designed in accordance with the legal acts and meets the requirements for achieving the objectives. From the examination of all the documents, some inaccuracies also result (in more detail in the report). (Standard II.1, Criteria 1 and 4, Standard II.3, Criteria 2).
2. GVJ notes that the Department of Mechanics also performs NJSBC services by managing quality assurance and quality control of study programs offered by the same department. (Standard I.3, Criterion 2 and Standard III. 1, Criterion 6).
3. The External Evaluation Group has identified that the institution does not have a centralized information and communication management system. (Standard IV.4, Criteria 1, 3).

Recommendation

1. GVJ recommends correcting the inaccuracies and adapting the Categories of Formative Activities (A-E) to the requirements of VKM no. 879/2019, increasing the credits for category B subjects, and decreasing the credits of category C, bringing them according to legal requirements (Standard II. 1, Criterion 1, 4).
2. GVJ recommends that the Institution should contract an external expert for quality assessment.
3. GVJ thinks that the addition of academic and auxiliary staff in the departments would improve the quality of teaching, laboratories, practices, etc.
4. GVJ recommends the addition of vehicle profile books to library items (Standard IV. 3, criterion 2).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Celvyshes *JA*